



Migrimi potencial i banorëve *nga rajoni i Korçës*

**DENISA TITILI
MARIA DOJÇE
VIOLA DOLANI
ELJONA TASHO
IRENA NIKAJ**



MIGRIMI POTENCIAL I BANORËVE NGA RAJONI I KORÇËS

Denisa Titili

Maria Dojçe

Viola Dolani

Eljona Tasho

Irena Nikaj

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Rezultatet e studimit mbi migrimin potencial të banorëve nga rajoni i Korçës, në kuadër të projektit:

“Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës”

(Studimi i përmasave të migrimit të mundshëm të banorëve nga rajoni i Korçës dhe analizimi i impaktit të tij për rajonin)

financuar nga të ardhurat e Universitetit “Fan S. Noli”,
Shtator 2025

Autorë:

Dr. Denisa Titili, Departamenti i Shkencave Sociale, Fakulteti Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Dr. Maria Dojçe, Departamenti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Msc. Viola Dolani, Departamenti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Prof. asc. dr. Eljona Tasho, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Prof. Dr. Irena Nikaj, Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
Nuk lejohet shumëfishimi i pjesëve apo i tërë librit përmes
fotokopjimit dhe as me ndonjë mënyrë tjetër pa lejen me shkrim të
autorëve

ISBN: 978-9928-836-09-0



Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	9
<i>Përkufizimi i koncepteve kyç.....</i>	11
<i>Rëndësia e studimit të migrimit potencial.....</i>	13
<i>Sfondi i përgjithshëm i migracionit shqiptar</i>	14
METODOLOGJIA E PUNËS.....	18
REZULTATET E STUDIMIT	22
1. PRIRJET PËR MIGRIM TË BRENDSHËM.....	22
1.1. Përmasat e migrimit potencial brenda vendit.....	22
1.2. Karakteristika të përgjithshme të migrantëve potencial të brendshëm.....	25
2. PRIRJET PËR TË EMIGRUAR JASHTË VENDIT.....	29
2.1. Përmasat e emigrimit potencial nga Shqipëria.....	29
<i>Kur planifikojnë të emigrojnë?.....</i>	34
2.2. Karakteristika demografike dhe socio-ekonomike të emigrantëve potencial.....	37
<i>Migrimi potencial dhe grupmosha.....</i>	37
<i>Migrimi potencial dhe gjinia.....</i>	38
<i>Migrimi potencial sipas nivelit arsimor.....</i>	39
<i>Migrimi potencial dhe statusi i punësimit.....</i>	41
<i>Migrimi potencial dhe statusi familjar.....</i>	44
<i>Migrimi potencial sipas të ardhurave në familje.....</i>	45
<i>Migrimi potencial sipas vendbanimit.....</i>	47
<i>Migrimi potencial sipas bashkive.....</i>	48
2.3. Faktorë shtytës / tërheqës të emigrimit potencial.....	49
<i>Arsyet që lidhen me synimin për të emigruar.....</i>	49
<i>Destinacionet kryesore për emigrantët potencial.....</i>	52
<i>Sbkalla e informimit të migrantëve potencialë rreth destinacionit të përzgjedhur.....</i>	57
2.4. Vendimmarrja për të emigruar.....	58
2.5. Migrim individual apo migrim familjar?.....	60
2.6. Planet për kohën e qëndrimit në vendin pritës.....	62
<i>Plani për kthim në vendlindje.....</i>	65
2.7. Niveli i kënaqësisë/pakënaqësisë ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike.....	67
3. NDIKIME DHE PASOJA TË MIGRIMIT TË MUNDSHËM PËR ZHVILLIMIN E RAJONIT.....	73
PËRFUNDIME.....	81
REFERENCA.....	86

Listë e grafikëve

- Grafiku 1. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “A mendoni të largoheni në një qytet tjetër brenda Shqipërisë?”
- Grafiku 2. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “Në cilin qytet planifikoni të largoheni?”
- Grafiku 3. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “A po mendoni të largoheni nga Shqipëria?”
- Grafiku 4. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “A keni bërë ndonjë hap konkret për të emigruar?”
- Grafiku 5. Grafiku i krostabulimit të të dhënave për variablat: “grupmosha” dhe “synimi për të emigruar”
- Grafiku 6. Migrimi potencial sipas përkatësisë gjinore të të anketuarve
- Grafiku 7. Migrimi potencial dhe arsimimi
- Grafiku 8. Migrimi potencial sipas statusit të punësimit të të anketuarve
- Grafiku 9. Kënaqësia/pakënaqësia ndaj tregut të punës për migrantët potencial me status i/e punësuar
- Grafiku 10. Migrimi potencial dhe statusi familjar
- Grafiku 11. Migrimi potencial sipas të ardhurave familjare të të anketuarve
- Grafiku 12. Migrimi potencial sipas vendbanimit
- Grafiku 13. Migrimi potencial sipas bashkive përkatëse të qarkut Korçë
- Grafiku 14. Arsyet kryesore të emigrimit potencial të banorëve
- Grafiku 15. Grafiku i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen “Çfarë do të bëntë të ndryshonit mendim për të mos u larguar nga vendi?”
- Grafiku 16. Destinacionet kryesore të emigrantëve potencial
- Grafiku 17. Arsyet e përzgjedhjes së vendit të destinacionit për migrantët potencial
- Grafiku 18. Shkalla e informimit të migrantëve potencialë për vendin pritës
- Grafiku 19. Vendimmarrja për të emigruar
- Grafiku 20. Kohëzgjatja e planit migrator
- Grafiku 21. Planet për kthim në vendlindje të migrantëve potencial
- Grafiku 22. Shkalla e kënaqësisë/pakënaqësisë së migrantëve potencial ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (%)
- Grafiku 23. Shkalla e kënaqësisë/pakënaqësisë ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (për të gjithë të anketuarit) (%)
- Grafiku 24. Raporti i varësisë së të moshuarve sipas, qarkut (%)

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Listë e tabelave

- Tabela 1. Numri i banorëve në qarkun Korçë 1989- 2023 (sipas të dhënave të Instat)
- Tabela 2. Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me pyetjen “Cilat janë arsytet pse doni të zhvendoseni në një qytet tjetër? (%)”
- Tabela 3. Krostabulimi i të dhënave për variablat: “grupmosha”; “destinacioni i lëvizjes” dhe “arsyet e zhvendosjes në një qytet tjetër” (%)
- Tabela 4. Krostabulimi i të dhënave për variablat: “grupmosha”; “gjinia” dhe “arsyet e zhvendosjes në një qytet tjetër” (%)
- Tabela 5. Krostabulimi i të dhënave për variablat: “niveli arsimor” dhe “synimi për të emigruar” (%)
- Tabela 6. Migrantët potencial sipas kohës kur planifikojnë të emigrojnë (%)
- Tabela 7. Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘konkretizimi i planit migrator’ dhe ‘koha’ kur planifikojnë të emigrojnë (%)
- Tabela 8. Rezultatet e testit hi- katror për lidhjen ndërmjet variablave: ‘koha kur planifikojnë të largohen’ dhe ‘konkretizimi i planit migrator’
- Tabela 9. Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘vendimmarrja për të emigruar’ dhe ‘mbështetja nga familjarët e vendimit për migrim’
- Tabela 10. Plani për migrim individual apo migrim familjar (%)
- Tabela 11. Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘plani për migrim familjar/ individual’ dhe ‘grupmosha’(%)
- Tabela 12. Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘kohëzgjatje e planit migrator’ dhe ‘arsyet për emigrimin’
- Tabela 13. Shkalla e kënaqësisë /pakënaqësisë së migrantëve potencial ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (%)
- Tabela 14. Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘migrim individual/ familjar’ dhe ‘prania e të moshuarve në familje’ (%)
- Tabela 15: Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘grupmosha’ dhe ‘numri i anëtarëve në familje’

HYRJE

Emigracioni përbën një dukuri karakterizuese të shoqërisë shqiptare. Studimet tregojnë se Shqipëria është ndër vendet kryesore në botë për shkallën e stokut të emigrantëve kundrejt popullsisë rezidente. Të dhënat nga Censi 2023 tregojnë se popullsia banuese në Shqipëri në vitin 2023 pati një rënie prej 420 mijë banorësh krahasuar me popullsinë banuese në vitin 2011¹. Një ndër faktorët kryesorë që ka kontribuar në zvogëlimin e numrit të popullatës është edhe emigracioni. Rajoni juglindor është prekur gjithashtu ndjeshëm prej dukurisë së tkurrjes së popullatës. Të dhënat prej INSTAT tregojnë se në vitin 2011 në qarkun e Korçës popullsia banuese ishte 220 900 banorë, ndërsa në vitin 2023 popullsia banuese e këtij qarku ishte 173.000 banorë (47.900 banorë më pak). Sipas të dhënave statistikore në qarkun e Korçës jetojnë vetëm 7% e popullsisë së të gjithë vendit². Ndërkohë që rajoni i Korçës mbetet një pol i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor (ekonomisë bujqësore, turizmit natyror dhe kulturor, zhvillimin e sektorit të shërbimeve etj), të gjitha këto impaktohen ndjeshëm prej faktorit demografik dhe veçanërisht prej lëvizjeve migratore të popullatës në këtë rajon. Ndërveprimi kompleks i variablave demografikë dhe dukurisë së migracionit sjell pasiguri dhe shqetësim lidhur me zhvillimet e ardhshme demografike, ekonomike dhe sociale të rajonit dhe vendit, të lidhura me disa arsye kryesore:

Së pari, shkalla e lartë e migracionit. Të dhënat e INSTAT tregojnë se vetëm gjatë periudhës 2011–2021 mbi 500 mijë persona kanë emigruar, çka dëshmon për vazhdimësinë dhe intensitetin e lartë të këtij fenomeni (INSTAT, 2022).

Së dyti, numri i emigrantëve të kthyer mbetet shumë i kufizuar. Të dhënat e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM, 2021) tregojnë se përqindja e shqiptarëve që rikthehen është shumë më e vogël sesa numri i atyre që emigrojnë, duke dëshmuar për një bilanc migrator negativ dhe rikthim të kufizuar.

Së treti, të rinjtë përfaqësojnë grupmoshën më të prirur për të emigruar duke sjellë kështu largimin e pjesës më aktive të shoqërisë në aspektin riprodhues. Në studimin e Westminster Foundation for Democracy 2020, Shqipëria rezulton vendi me plakjen më të shpejtë të popullsisë në rajon dhe një ndër vendet me plakjen më të shpejtë në Europë. Sipas këtij studimi, emigrimi masiv, sidomos i grupmoshave të reja përbën faktorin kryesor të plakjes së popullsisë.

¹ Censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri 2023 <https://www.instat.gov.al/media/13615/censi-popullsisë-2023.pdf>

² Po aty

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Studimi parashikon se nëse vijohet me këtë ritëm deri në vitin 2050 mosha mesatare e popullatës në Shqipëri mund të shkojë deri në 50 vjeç (të gjitha këto arsye të sipërpërmendura derivojnë prej analizimit të treguesve statistikorë që vijnë prej burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare si INSTAT, IOM, ILO etj). Studimet gjithashtu tregojnë se migrimi potencial mbetet i lartë³. Ka një numër të madh banorësh të cilët synojnë dhe planifikojnë të largohen nga vendi. Migrimi potencial i referohet dëshirës, prirjes apo planit të individëve, veçanërisht të rinjve, për të emigruar jashtë vendit. Ky fenomen është bërë gjithnjë e më i dukshëm gjatë dekadave të fundit, i nxitur nga faktorë ekonomikë, socialë, arsimorë dhe politikë. Shumë qytetarë shqiptarë, veçanërisht të rinjtë dhe profesionistët e kualifikuar, shprehin dëshirën për të kërkuar mundësi më të mira pune, cilësi më të lartë jetese dhe siguri sociale në vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore apo më gjerë. Migrimi potencial shpeshherë shërben si një indikator për problemet strukturore brenda vendit, si papunësia, paga e ulët, korrupsioni, mungesa e perspektivës për të ardhmen apo sistemi i dobët arsimor dhe shëndetësor. Kjo dëshirë për largim nuk është vetëm një zgjedhje individuale, por reflekton gjendjen e përgjithshme të mirëqenies dhe besimit qytetar ndaj institucioneve dhe të ardhmes së vendit. Studimi i migrimit potencial merr një rëndësi të veçantë pasi mundëson identifikimin e prirjeve për emigrim të banorëve përpara se ai të shndërrohet në migrim real.

Migrimi potencial përbën një fushë të re studimi në mjedisin kërkimor shqiptar, çka sjell një mungesë të të dhënave dhe treguesve mbi mundësinë dhe planifikimin për emigrim të banorëve në Shqipëri (migrimi potencial). Shumica e studimeve përqëndrohen në migrimin real, ndërsa migrimi potencial si në planin konceptual ashtu dhe atë metodologjik mbetet një risi dhe ka nevojë të studiohet. Të dhënat e fundit lidhur me migrimin potencial vijnë nga një studim i QSES (Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale) në 2018. Studimi është në nivel kombëtar dhe numri i njëjësive familjare të anketuara në raport proporcional për qarkun e Korçës është 100 njësi familjare (të anketura) nga 60171 njësi familjare që kishte qarku sipas të dhënave nga Instat 2011. Ky tregues nuk pasqyron në mënyrë të plotë tendencat për migrimin potencial të banorëve nga ky qark. Gjithashtu vlen të theksohet se ka një mungesë të dhënash në një hark kohor shtatë vjeçar në kushtet kur ndryshimet demografike përgjatë viteve të fundit janë intensifikuar së tepërmi, gjë e cila shtron nevojën për një përditësim të pasqyrës së migrimit potencial në rajonin e Korçës. Nga njëra anë treguesit rreth rënies së popullatës, tendencës në rritje për emigracion të të rinjve

³ Gallup, The World's Potential Migrants, https://www.migrationinstitute.org/files/news/gallup_whitepaper_migration-1.pdf

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

dhe indeksit të plakjes së popullatës në vend, dhe nga ana tjetër mungesa e një studimi të tillë në nivel qarku, shtron nevojën për studimin e prirjeve për migrim të mundshëm në të ardhmen të banorëve dhe veçanërisht të të rinjve nga rajoni i Korçës. Konkretisht merr rëndësi:

- studimi i përmasave të migrimit potencial (sa planifikojnë të largohen dhe ku)
- arsyet pse planifikojnë të largohen;
- kohëzgjatja e projektit migrator;
- identifikimi nëse projekti migrator përfshin vetëm një individ apo gjithë njësinë familjare;
- plani për rikthim pas përmbushjes së qëllimit të projektit migrator, etj.

Nevoja për matjen e migrimit potencial lidhet jo vetëm me mungesën e të dhënave të fundit në lidhje me këtë dukuri, por gjithashtu justifikohet prej nevojës për të analizuar pasojat e mundshme që sjell migrimi potencial për zhvillimin e rajonit dhe marrjen e masave për kontrollin dhe menaxhimin e këtyre pasojave. Analiza e treguesve mbi migrimin potencial ndihmon të kuptohet se cilat janë shtysat kryesore (ekonomike, sociale, politike apo kulturore) që motivojnë individët të largohen, dhe cilat kategori të popullsisë janë më të prekshme. Një qasje e tillë u jep politikbërësve dhe institucioneve mundësinë të parashikojnë ndryshimet demografike, të planifikojnë më mirë politikatat publike dhe të hartojnë strategji parandaluese për të ruajtur kapitalin njerëzor. Për më tepër, migrimi potencial ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen ekonomike, sociale dhe politike të një vendi, pasi lidhet me strukturën e tregut të punës, plakjen e popullsisë dhe zhvillimin afatgjatë të shoqërisë.

Përkufizimi i koncepteve kyç

Migrimi potencial

Referuar IOM (Organizata Ndërkombëtare e Migracionit) migrimi potencial përcaktohet si *‘numri absolut i personave në moshë madhore që planifikojnë apo përgatiten të migrojnë, në raport me numrin e popullsisë në vendin përkatës’*⁴.

⁴ Lazcko F., Tjaden J., Auer D. (2017) Measuring Global Migration Potential, 2010–2015. Berlin: Global Migration Data Analysis Centre, Data Briefing Series 9, f. 1.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Migrimi potencial i referohet synimit ose gatishmërisë së individëve për të migruar, edhe nëse nuk kanë ndërmarrë ende hapa konkretë për ta realizuar këtë lëvizje. Ai përfshin qëndrimet, dëshirat dhe planet për migrim në të ardhmen, qoftë brenda vendit (migrim i brendshëm) apo jashtë tij (migrim ndërkombëtar). Migrimi potencial përfaqëson predispozitën apo vullnetin e individëve për të lëvizur nga vendbanimi i tyre aktual drejt një vendi tjetër, bazuar në aspirata personale, sociale apo ekonomike, pavarësisht nëse ata kanë ndërmarrë ose jo veprime konkrete për realizimin e kësaj lëvizjeje. Në kontekste kërkimore apo sociologjike, studimi i migrimit potencial ndihmon në kuptimin e flukseve të mundshme migratore dhe faktorëve që ndikojnë në vendimmarrjen për migrim. Identifikimi i përmasave të migrimit potencial (së bashku me karakteristikat dhe motivet që çojnë në planifikimin e projektit migrator) lejon marrjen në kohë të masave për frenimin e flukseve migratore (përmes nënsistemeve sociale të kontrollit) apo minimizimin e pasojave negative që sjell kjo dukuri në planin ekonomik e social.

Migrimi i brendshëm

Në lidhje me termat “migrimi i brendshëm” dhe “migrimi i jashtëm” ne i kemi referuar përkufizimit të IOM (Organizata Ndërkombëtare e Migracionit) në botimin “Fjalorth i terminologjisë migratore” (2007). Termi “migrim (migracion) i brendshëm” përdoret për të përshkruar procesin e lëvizjes së personave nga një zonë e një vendi në një tjetër që ka si qëllim apo rezultat vendosjen në një vendbanim të ri. Migrimi i brendshëm mund të jetë i përkohshëm apo i përhershëm. Migrantët e brendshëm lëvizin, por, duke mbetur brenda kufijve territorialë të vendit të origjinës (p.sh. migrimi nga zonat rurale drejt atyre urbane) (IOM, 2007: 35). Migrimi i brendshëm përkufizohet duke u bazuar në dy përmasa: përmasën hapësinore dhe atë kohore. Përmasa hapësinore e migrimit të brendshëm nënkupton lëvizjen migratore të banorëve ndërmjet rajoneve, prefekturave, rretheve të së njëjtës prefekturë, ndërmjet komunave dhe ndërmjet fshatrave dhe qytetit. Ndërsa përmasa kohore e migrimit të brendshëm, referuar studimeve në fushën e migracionit në Shqipëri, përfshin migrimin afatgjatë nga data e lindjes deri në vitin 2000, migrimin afatmesëm nga 1989-2001 dhe migrimin e kohëve të fundit 2000-2001⁵.

⁵ Shih: INSTAT 2004, Migracioni në Shqipëri, 2001, faqe 11-18

Migrimi ndërkombëtar

Migrimi (migracioni) i jashtëm/ndërkombëtar, përkufizohet si lëvizja e personave që largohen nga vendi i tyre i origjinës ose vendqëndrimi i zakonshëm, për t'u vendosur në mënyrë të përhershme apo të përkohshme në një shtet tjetër. Gjatë kësaj lëvizjeje kalohet kufiri ndërkombëtar (IOM, 2007:36). Kur merret në konsideratë kohëzgjatja e migracionit, shfaqen dy nënndarje të këtij përkufizimi. Së pari, “migrant afatgjatë” konsiderohet një person i cili lëviz në një vend të ndryshëm nga ai i qëndrimit të zakonshëm për një periudhë të paktën një vit (12 muaj), pra vendi i destinacionit bëhet në vendi i tij/saj i ri i qëndrimit. Nga ana tjetër, “migrant afatshkurtër” është një person i cili lëviz në një vend për një periudhë më të shkurtër se 12 muaj, përveç rasteve kur lëvizja drejt atij vendi është për qëllime argëtimi, pushimi, vizitash tek miqtë e të afërmit, biznes, trajtim mjekësor apo pelegrinazh fetar” (vepër e cit⁶).

Rëndësia e studimit të migrimit potencial

Janë ndërmarrë shumë studime për të shqyrtuar thellësinë dhe madhësinë e migracionit të brendshëm dhe ndërkombëtar në Shqipëri (IOM, 2007; Vullnetari, 2007; Carletto et al., 2004; Titili 2023), duke analizuar prirjet, destinacionet dhe ndikimet socio-ekonomike të këtyre lëvizjeve. Megjithatë, pavarësisht vëmendjes që i është kushtuar këtyre formave të migrimit, studimet që fokusohen posaçërisht te migrimi potencial – pra, qëllimet, dëshirat apo planet për të migruar – janë ende të pakta. Të kuptuarit e migrimit potencial mbetet thelbësor për parashikimin e flukseve të ardhshme migratore dhe për hartimin e politikave efektive të zhvillimit dhe planifikimit demografik. Migrimi potencial është një tregues domethënës i migrimit real në të ardhmen. Identifikimi i përmasave të migrimit potencial të banorëve dhe veçanërisht të rinjve, nga rajoni i Korçës mundëson krijimin e një panorame të asaj se çfarë pritet të ndodhë dhe pasojave me të cilat pritet të përballet rajoni në të ardhmen. Është e rëndësishme të studiohet migrimi potencial për të dhënë një tregues mbi flukset e mundshme migratore:

- Kush po planifikon ose po përgatitet të migrojë?
- Në cilat vende planifikojnë të migrojnë njerëzit?
- Cilat janë arsyet e migrimit?

⁶ IOM 2008, Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer, faqe 9

Njohja dhe analizimi i karakteristikave socio- demografike të migrantëve potencialë nga ana tjetër kontribuon në zhvillimin e skenarëve të migrimit dhe parashikimin pasojave që mund sjellë fenomenni për zhvillimin në të ardhmen. Implikimet e asaj që mund të ndodhë nëse migrimi potencial kthehet në migrim real përbën një motiv të rëndësishëm për të marrë masa dhe për të planifikuar ndërtimin e strategjive të zhvillimit dhe migrimit, tani dhe në të ardhmen. Nëse përmasat e migrimit potencial janë të mëdha, kjo do të sjellë pasoja të konsiderueshme në të ardhmen kur ky migrim të kthehet në migrim real. Këto pasoja impaktojnë familjen, shoqërinë, arsimin, sistemin e mbrojtjes sociale, ekonominë etj. Sigurisht që migrimi ndikon në zhvillimin e vendit të origjinës (përmes remitancave financiare dhe sociale). Por vazhdimi i pandalshëm i flukseve migratore sjell pasoja negative më tepër se sa zhvillim të shoqërive dërguese; pasoja që lidhen me rënien e popullatës, depopullim të rajoneve periferike, largim i trurit etj. Një dukuri e tillë ndikon dukshëm në të gjitha aspektet, në planin social, ekonomik, në arsim, shëndetësi, etj. Studimi i përmasave të migrimit potencial të banorëve nga rajoni i Korçës do të krijojë mundësi për ndërmarrjen e hapave të mirëplanifikuar në drejtim të menaxhimit dhe minimizimit të risqve sociale që vijnë prej migracionit në rritje. Një pasqyrë e tillë të dhënash rreth migrimit potencial do t'i vijë në ndihmë të gjithë politikbërësve vendor dhe aktorëve social për të planifikuar dhe projektuar mundësitë e zhvillimit të rajonit në perspektivën e afërt dhe të largët.

Gjithashtu identifikimi i përmasave të migrimit potencial të banorëve dhe kryesisht të rinjve nga rajoni i Korçës do të shërbejë si një bazë e mirë të dhënash për ndërmarrjen e studimeve të tjera në të ardhmen prej studiuesve dhe ekspertëve shkencorë në disiplinat që implikohen dhe impaktohen prej dukurisë së migrimit të banorëve (fushën e arsimit, ekonomisë, menaxhimit dhe administrimit, sferën sociale, politikat e mirëqenies, planifikimin dhe zhvillimin urban etj).

Sfond i përgjithshëm i migracionit shqiptar

Migracioni përfaqëson dukuri të qëndrueshme sociale dhe ekonomike për shoqërinë shqiptare të pas viteve '90'. Dukuria e migrimit ka qenë në qendër të ndryshimeve ekonomike, politike, sociale e kulturore në Shqipëri, pasi që prej vitit 1990 shoqëria shqiptare ka përjetuar në mënyrë intensive migracion të brendshëm (kryesisht rural-urban) dhe të jashtëm. Migrimi shqiptar është shoqëruar me pasoja të thella në strukturën demografike të vendit, sidomos në zonat rurale dhe ato malore, duke ndikuar në uljen e popullsisë, plakjen demografike dhe depopullimin e shumë zonave.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Nga ana tjetër, remitancat e emigrantëve kanë qenë për një kohë të gjatë një burim i rëndësishëm për ekonominë shqiptare dhe për mirëqenien e shumë familjeve. Migracioni mbetet një dukuri komplekse për Shqipërinë moderne. Sipas INSTAT (2004), 700,000 shqiptarë janë larguar nga vendi gjatë periudhës 1989-2001 dhe në vitin 2005 numri i emigrantëve u rrit në 864,485, që përbën 27.5% të popullsisë totale në vend (Banka Botërore, 2005). Në vitet e mëpasme (2006 dhe më pas) migracioni u bë më i vështirë për shqiptarët (zbatimi i rregullave për kalimin e kufirit) dhe fluksi i fundit i migracionit ndërkombëtar ka të bëjë me shqiptarët që lëvizën nga vendet parësore të destinacionit (si Italia, Greqia) në vende të tjera, kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada. Në një Profil Migracioni të viti 2007, studiuar nga IOM konstatohet se vendet si Greqia dhe Italia janë identifikuar si vende parësore të destinacionit (përkatësisht 434,810 migrantë në vitin 2003 dhe 348,813 migrantë në vitin 2006). Vende të tjera në nivele të larta ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja dhe Gjermania⁷. Ndërsa treguesit rreth migracionit shqiptar të kohëve të fundit tregojnë për një zhvendosje të flukseve migratore të shqiptarëve drejt vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore, si Gjermani, Mbretëri e Bashkuar, ku kërkesa për fuqi punëtore dhe mundësitë e integritit janë më të mëdha (Instat 2023; IOM 2020).

Ka pasur një traditë emigrimi të popullsisë shqiptare para viteve 90', por ne po i referohemi emigracionit modern shqiptar i cili fillon në vitet 1990-1991, dhe në dekadën e tij të parë ishte një emigrim masiv, i parregullt, spontan, kryesisht mashkullor. Deri në vitin 2000 vlerësohej se rreth 800,000 shqiptarë jetonin dhe punonin jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali⁸. Në dekadën e dytë të emigrimit, ajo e viteve 2000, fluksi i largimit të shqiptarëve vijoi, por me një intensitet pak më të ulët. Viti 2000 shënon një pikë kthese për migracionin shqiptar; flukset migratore dhe intensiteti i tyre fillon të ngadalësohet. Vitet 2000-2007 karakterizohen nga një stabilitet ekonomik dhe politik në vend, duke shënuar kështu fundin e emigracionit masiv shqiptar (Vullnetari J, 2007; Maroukis Th & Gemi E, 2011; IOM, 2007). Kjo rënie e flukseve migratore i atribuohet gjithashtu edhe përforcimit të legjislacionit dhe mekanizmave të kontrollit të migrimit në Greqi dhe Itali (të cilat përbënin destinacionin kryesor të emigrantëve

⁷ IOM, 2008, Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer, faqe 17

⁸ Barjaba K. (2000) Contemporary patterns in Albanian migration, South-East Europe Review, 3(2): 57-64.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

shqiptarë) (Gëdeshi I, & Jorgoni E, 2012: 7). Gjatë kësaj dekade edhe gjeografia e destinacionit është diversifikuar dhe përfshin tashmë vende të tjera evropiane, në mënyrë të veçantë Mbretërinë e Bashkuar, si dhe vendet e Amerikës së Veriut. Dekada e tretë e migrimit është karakterizuar nga një rigjallërim i intensitetit, veçori të reja dhe destinacione të reja. Studimet tregojnë se ende ka një shkallë të lartë të migracionit në vend. Sipas të dhënave të Instat në vitin 2023 popullsia banuese në Shqipëri ka një rënie prej 420 mijë banorësh krahasuar me vitin 2011 (Censi 2023). Gjithashtu të dhënat tregojnë se ka një tkurrje të ndjeshme të popullatës edhe në rajonin juglindor. Sipas INSTAT në vitin 2023 në qarkun e Korçës banojnë 47. 900 banorë më pak se në vitin 2011.

Qarku i Korçës karakterizohet nga lëvizje migratore si të brendshme ashtu edhe ndërkombëtare. Migrimi i brendshëm karakterizon kryesisht zonat rurale, banorët e të cilëve zhvendosen drejt qytetit për shkak të faktorëve që lidhen me nivelin e ulët të jetesës në fshat, papunësia, pakënaqësia në lidhje me infrastrukturën dhe shërbimet publike (arsimi, sistemi i kujdesit shëndetësor), etj. Migrimi i brendshëm po ashtu përfshin edhe banorët e zonave urbane të qarkut të cilët largohen drejt kryeqytetit apo qendrave më të mëdha urbane. Për sa i përket dukurisë së emigracionit, qarku i Korçës është karakterizuar nga një nivel i lartë emigrimi i banorëve veçanërisht në Greqi, dukuri e cila lidhet si me afërsinë gjeografike ashtu edhe me një traditë të trashëguar nga e kaluara. Qyteti i Korçës është destinacioni i dytë më i rëndësishëm (krahas Tiranës) për migrantët nga zonat rurale të pjesës juglindore të vendit (Vullnetari J, 2012: 119). Korça është poli rajonal më i rëndësishëm i juglindjes, i lokalizuar përgjatë një rreze prej rrugëve më të rëndësishme tregtare që lidhin Shqipërinë me Ballkanin dhe vendet e Evropës, përmes Maqedonisë dhe Greqisë.

Po u referohemi disa treguesve të popullsisë për periudhën 1990- 2010, të cilët tregojnë se në qytetin e Korçës numri i banorëve ka ndryshuar vazhdimisht për shkak të dukurisë të migrimit. Kështu në vitin 1990 numri i banorëve në qytetin e Korçës llogaritej 65.000 banorë, në vitin 1995 numri i banorëve ishte 73. 499 dhe në vitin 2000 numri ishte 80.772 banorë. Prej vitit 1991 deri në vitin 2000 numri i të ardhurve në qytetin e Korçës vlerësohet 16.646 të ardhur dhe 8124 të larguar (Projekt programi i zhvillimit rajonal të qytetit të Korçës, 2001).

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Harta e Qarkut Korçë

Po ashtu të dhënat nga Zyra e Statistikës në qarkun e Korçës tregojnë se në vitin 2005 në qytetin e Korçës numri i banorëve ishte 85.590 banorë. Në vitin 2005 numri i të ardhurve në qytet vlerësohet 2.456 banorë dhe numri i të larguarve 1.163 banorë. Në vitin 2008 në qytetin e Korçës kishte 716 banorë të ardhur nga zonat rurale, prej të cilëve 524 femra dhe 192 meshkuj, ndërsa të larguarit nga qyteti i Korçës (kryesisht në Tiranë dhe emigrantë në Greqi) arrinin shifrën 614 prej të cilëve 178 femra dhe 436 meshkuj (Buletini statistikor, Bashkia Korçë, 2008). Në vitin 2009 në qytetin e Korçës numri i banorëve në fund të vitit ishte 86.596, numri i të ardhurve 925 dhe numri i të larguarve 572 banorë. Të dhënat demografike për të gjithë qarkun e Korçës tregojnë se ka një rënie të numrit të popullsisë në të gjithë qarkun përgjatë viteve.



Tabela 1 tregon numrin e banorëve në qarkun Korçë për periudhën 1989- 2023. Referuar këtyre treguesve konstatohet se nga viti 1989 deri në vitin 2023, popullsia është tkurrur me rreth 138 mijë banorë (afërsisht 44% rënie), e lidhur ngushtë kryesisht me emigracionin. Të dhënat tregojnë se rënia e popullsisë ka ndodhur në mënyrë pothuajse konstante gjatë tri periudhave të matura, çka mund të themi se migrimi përbën një dukuri të qëndrueshme për banorët e rajonit të Korçës.

Tabela 1: Numri i banorëve në qarkun Korçë 1989- 2023 (sipas të dhënave të INSTAT)

<i>Viti</i>	<i>Popullsia Totale</i>	<i>Burimi</i>
1989	311,448	Regjistrimi i Popullsisë 1989
2001	265,182	Censuri i Popullsisë dhe banesave 2001
2011	220,357	Censuri i Popullsisë dhe banesave 2011
2023	173,091	Censi i Popullsisë dhe banesave 2023

Sot, në kontekstin e sfidave të tranzicionit të zgjatur, mungesës së perspektivës ekonomike dhe besimit të ulët në institucionet shtetërore, migrimi potencial vijon të mbetet i lartë, veçanërisht në radhët e të rinjve dhe profesionistëve të kualifikuar, duke ngjallur shqetësime për të ardhmen e zhvillimit të vendit. Sipas të dhënave nga Gallup World Poll për periudhën 2010 - 2015, Shqipëria renditet e gjashta në botë për nga përqindja e të rriturve që ‘planifikojnë të migrojnë’⁹. Bazuar në raportet e publikuara në nivel global dhe rajonal nga Gallup dhe organizata që kanë analizuar të dhënat e tyre (si IOM dhe UNDP) ka një rritje të dukshme të migrimit real dhe potencial nga Shqipëria në dekadën e tretë të migracionit. Në lidhje me këta tregues, studimet paralajmërojnë se Shqipëria është ndër vendet më të rrezikuara nga humbja e kapitalit njerëzor, veçanërisht për shkak të dëshirës për emigrim të individëve me arsim të lartë dhe aftësi profesionale. Duke u bazuar në këto tregues, studimi jonë përqendrohet në shqyrtimin dhe analizimin e përmasave të migrimit potencial të banorëve dhe veçanërisht të të rinjve nga rajoni i Korçës. Analizimi i të dhënave të anketës do të ndihmojë për të kuptuar prirjen për migrim dhe implikimeve që kjo dukuri ka për shoqërinë dërguese.

METODOLOGJIA E PUNËS

Migrimi potencial përbën një fushë studimi me shumë rëndësi në mjedisin kërkimor shqiptar dhe për pasojë përbën një sfidë si në planin konceptual ashtu edhe atë metodologjik. Metodologjikisht migrimi potencial mund të studiohet në dy mënyra:

- Së pari, në nivelin makrologjik, migrimi potencial mund të shihet brenda një kuadri të variablave strukturore të varura nga koha, të tilla si rëniet në veprimtarinë ekonomike, paqëndrueshmëria politike apo brishtësia mjedisore në një vend a rajon të dhënë¹⁰
- Së dyti, migrimi potencial mund të studiohet përmes vrojtimit të drejtpërdrejtë të dukurisë (anketa, intervista, etj).

Puna kërkimore për këtë studim është bazuar në analizën e të dhënave parësore të siguruara përmes metodës sasiore të anketimit. Llogaritja e migrimit potencial

⁹ Lazcko F., Tjaden J., Auer D. (2017) Measuring Global Migration Potential, 2010–2015. Berlin: Global Migration Data Analysis Centre, Data Briefing Series 9, f. 7

¹⁰ Gëdeshi & King, 2018, Tendencat e reja të migrimit potencial nga Shqipëria, CESS, fq. 17

bëhet nëpërmjet anketimeve që realizohen me banorët në lidhje me synimet, planet dhe përgatitjet e tyre për migrim në të ardhmen. Bazar në standartet metodologjike për hartimin e pyetësorëve për qëllime studimore rekomandohet përdorimi i pyetësorëve të standartizuara. Për qëllimet e këtij studimi pyetësori që u përdor përmbante pyetje të paracaktuara dhe standarte, referuar instrumentit matës të përdorur nga një studim i IOM (i cili do të përmbush edhe kriterin e standartizimit), por i përshtatur në kontekstin në të cilin ndodh studimi. Në hartimin e anketës mori rëndësi të veçantë formulimi i pyetjeve rreth identifikimit të migrimit potencial; pra përcaktimi i qartë i variablave. Studimet rreth migrimit potencial bazohen në disa variabla si “*dëshira për të migruar*”, “*synimi për të migruar*” apo “*planifikimi/ përgatitja për të migruar*”¹¹. Anketimi ynë u fokusua kryesisht në identifikimin e migrimit potencial të banorëve nga rajoni i Korçës bazuar në variablin : “*planifikimi/ përgatitja për të migruar*, pasi ky variabël është tregues më i afërt i migrimit real në të ardhmen. Gjithashtu një variabël i rëndësishëm i studimit është variabli “*kohë*”, pra kuadri kohor në të cilin specifikohen planet për migrim. Studimi synoi identifikimin e migrimit potencial në një kuadër kohor deri 10 vjeçar me qëllim që të dhënat të jenë të qëndrueshme dhe të mundësojnë analiza dhe interpretime të qëndrueshme rreth implikimeve që mund të ketë migrimi potencial për (nën)zhvillimin e rajonit.

Për të siguruar përfaqësueshmërinë e të dhënave, kampioni i studimit u llogarit sipas formulës së Yamane¹² për llogaritjen e madhësisë së kampionit në studimet sociale, kur niveli i konfidencës = .05 (95%) dhe $P = .5$. Referuar të dhënave nga Censi 2023 popullsia banuese 18 vjeç e lart në qarkun e Korçës është 143.522 banorë. Bazuar në formulën e Yamane për llogaritjen e madhësisë së kampionit u anketuan 486 banorë në të gjithë qarkun. Theksohet se numri 486 i banorëve të anketuar tekjalon kufirin minimal të madhësisë së kampionit sipas formulës së Yamane. Një zgjedhje e tillë nga ana e studiuesve u bë me qëllim që të sigurohej qëndrueshmëri dhe saktësi e të dhënave, si edhe përfaqësim sa më i plotë i popullatës në studim.

Për shpërndarjen e anketave u përdor një kampion grupimi që u zhvillua në disa faza. Fillimisht, kampioni u nda sipas 6 bashkive të rajonit të Korçës, duke përdorur shpërndarjen proporcionale të popullsisë, sipas të dhënave të marra nga Censi 2023. Anketat u shpërndanë në mënyrë proporcionale për secilën bashki.

¹¹ Shih Gëdeshi & King “Tendencat e reja të migrimit potencial nga Shqipëria”, QSES, 2018, fq.18

¹² Israel D. G., (1992), Determining sample size, Univesity of Florida

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Në çdo bashki, u përzgjedhën njësitë parësore të kampionimit dhe më tej në mënyrë rastësore u përzgjedhën familjet/ individët të cilët u anketuan. Ekipi kërkimor tregoi kujdes që në secilën njësi familjare të anketohet vetëm një prej anëtarve të saj. Gjithashtu u tregua kujdes i veçantë për të anketuarit që të kuptohet qartë qëllimi i studimit. Anketa u pilotua në 50 subjekte për të testuar nivelin e qartësisë, kuptueshmërisë dhe lehtësisë së plotësisë nga ana e të anketuarve dhe njëkohësisht, u testua statistikisht për të parë vërtetësinë në analizimin dhe interpretimin e të dhënave dhe lidhjeve ndërmjet variablave. Gjatë fazës së pilotimit gjithashtu u përllogarit koeficienti Alfa e Chronbach-ut, për të matur nivelin e besueshmërisë (konsistencën e brendshme të shkallëve), ose përmasën në të cilën të gjitha pohimet e një shkalle masin të njëjtin koncept. Pasi u përpilua modeli final i anketës u realizua shpërndarja e saj në 486 të anketuar të zgjedhur sipas teknikës së kampionimit probabël. Pyetjet e anketës u organizuan në 4 sesione. Të dhënat e mbledhura u përpunuan statistikisht në programin statistikor SPSS. Për analizimin e të dhënave u përdoren statistika përshkruese, krostabulimi i të dhënave, analiza përshkruese krahasuese, teste statistikore, etj.

Kufizimet e studimit:

Ky studim mbi migrimin potencial të banorëve nga rajoni i Korçës, ofron një panoramë të rëndësishme mbi prirjet migratore të popullsisë, por përmban edhe disa kufizime metodologjike:

Së pari, shpërndarja e anketave u bë në mënyrë proporcionale sipas numrit të popullsisë në gjashtë bashkitë e rajonit, por nuk përfshiu të gjitha zonat rurale, veçanërisht një pjesë të fshatrave më periferike. Kjo ishte një zgjedhje e arsyeshme nga kërkuesit, pasi këto zona janë pothuaj të braktisura dhe nuk kanë popullsi aktive, sidomos të rinj, të cilët janë grupi më i rëndësishëm për analizimin e migrimit potencial.

Së dyti, të dhënat janë mbledhur nëpërmjet deklarimeve subjektive të të anketuarve, të cilat shprehin synime dhe aspirata që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe nën ndikimin e faktorëve të paparashikuar ekonomikë, socialë apo individualë.

Së treti, studimi mbështetet në të dhëna sasiore dhe nuk përfshin instrumente kualitative (intervista në thellësi), të cilat mund të pasuronin kuptimin mbi motivet subjektive dhe dimensionet kulturore të migrimit.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Në përmbledhje, këto kufizime nuk e zbehin vlefshmërinë e gjetjeve, por theksojnë rëndësinë e studimit si një pasqyrë e besueshme e prirjeve të ardhshme demografike dhe migratore në rajonin e Korçës. Studimi ofron tregues të qartë mbi tendencat që mund të formësojnë strukturën sociale dhe ekonomike të zonës në të ardhmen. Në të njëjtën kohë këto kufizime mund të shihen edhe si një nevojën për studime të mëtejshme gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinare, të orientuar kah fushave ku migrimi ka impakt të drejtpërdrejtë.

Karakteristika të të anketuarve:

Anketimi përfshiu 486 banorë në të gjithë qarkun e Korçës, prej të cilëve 288 (59.2%) femra dhe 198 (40.8%) meshkuj.

Shpërndarja e të anketuarve sipas vendbanimit tregoi se 54.3 % e tyre jetojnë në qytet dhe 44.4 % jetojnë në fshat. (1.3% e të anketuarve nuk e kishin deklaruar vendbanimin).

Në një paraqitje më të detajuar të shpërndarjes së të anketuarve sipas bashkive në të cilat u realizua studimi rezultoi se:

- 35.9% e të anketuarve i përkasin bashkisë Korçë
- 17.7% e tyre i përkasin bashkisë Devoll
- 29.7% e tyre i përkasin bashkisë Pogradec
- 4.1% e tyre i përkasin bashkisë Ersekë
- 11.8 % i përkasin bashkisë Maliq
- dhe 0.8 % e tyre i përkasin bashkisë Pustec

Në lidhje me shpërndarjen e të anketuarve sipas grupmoshës rezultoi se:

- 42.8 % e të anketuarve i përkasin grupmoshës 18- 24 vjeç
- 18.1 % e tyre i përkasin grupmoshës 25- 34 vjeç
- 19.3 % e tyre i përkasin grupmoshës 35- 44 vjeç
- 13.2 % e tyre i përkasin grupmoshës 45- 54 vjeç
- 6.6% i përkasin grupmoshës mbi 55 vjeç

Sa i takon shpërndarjes së të anketuarve sipas nivelit arsimor rezultoi se 10.1 % e të anketuarve janë me arsim të ulët (9 vjeçar); 44.2 % e tyre janë me arsim të mesëm; 42.8 % e të anketuarve janë me arsim të lartë (universitar) dhe 2.9 % e tyre kanë studime pasuniversitare.

REZULTATET E STUDIMIT

Të dhënat që rezultuan prej anketimit, së bashku me analizën dhe interpretimin e tyre janë organizuar në përputhje me sesionet përkatëse. Të dhënat e anketimit janë analizuar në përputhje me synimin për të migruar brenda vendit apo jashtë vendit dhe njëkohësisht shqyrtojnë arsyet e migrimit, faktorët shtytës, drejtimin e flukseve migratore, planet për kohëzgjatjen e projektit migrator si dhe raportin ndërmjet faktorëve demografikë, ekonomike e sociale.

Rezultatet e studimit mbi migrimin potencial të banorëve nga rajoni i Korçës treguan se 68.5% e të anketuarve shprehen se janë duke u përgatitur ose po konsiderojnë mundësinë për të migruar, brenda apo jashtë vendit. Ky tregues i lartë nënvizon intensitetin e prirjes për lëvizje dhe evidenton një shqetësim të thellë strukturor. Rezultati thekson se migrimi nuk mbetet një fenomen individual, por një proces i gjerë shoqëror që prek dinamika të rëndësishme demografike, ekonomike dhe sociale në vend. Në vijim do të shqyrtohen treguesit për migrimin potencial brenda vendit dhe treguesit për migrimin potencial jashtë Shqipërisë, së bashku me analizën e karakteristikave demografike dhe socio-ekonomike të migrantëve.

1. PRIRJET PËR MIGRIM TË BRENDSHËM

Migrimi i brendshëm, si pjesë integrale e mobilitetit të popullsisë, paraqitet po ashtu si një prirje e dukshme në kuadër të migrimit potencial të banorëve nga rajoni i Korçës. Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve synojnë lëvizjen drejt qendrave urbane brenda vendit, kryesisht për arsye që lidhen me punësimin, arsimin dhe aksesin në shërbime publike. Ky fenomen është i ndërlidhur ngushtë me proceset e urbanizimit, përqendrimin e resurseve në zonat metropolitane dhe boshatisjen graduale të zonave rurale. Analiza e këtyre prirjeve ka rëndësi të veçantë për kuptimin e transformimeve të brendshme shoqërore dhe për formulimin e politikave zhvillimore që synojnë balancimin territorial dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

1.1. Përmasat e migrimit potencial brenda vendit

Migrimi potencial i brendshëm në Shqipëri është një dinamikë e qëndrueshme dhe në rritje, që ndjek një model "nga periferia drejt qendrës", ku qytetet e mëdha

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

dhe zonat bregdetare tërheqin popullsinë nga zonat rurale dhe qytete të tjera periferike. Bazuar në të dhënat e anketimit rezultoi se 44.6% e të anketuarve mendojnë të largohen drejt një qyteti tjetër brenda Shqipërisë (29.3 % e tyre kanë një plan konkret për t'u larguar (janë duke u përgatitur) dhe 15.3 % mendojnë të largohen, por pa një plan konkret).

Figura 1: Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “A mendoni të largoheni në një qytet tjetër brenda Shqipërisë?”




Në lidhje me destinacionet kryesore të migrimit të brendshëm për banorët e qarkut të Korçës, Tërana mbetet qyteti më i preferuar për migrantët e brendshëm (76% e të anketuarve që kanë një plan konkret për t'u larguar drejt një qyteti tjetër brenda Shqipërisë kanë zgjedhur Tërana si destinacion). Të tjera qytete të përzgjedhura për migrantët e brendshëm janë Durrësi (për 6 % të të anketuarve që planifikojnë të migrojnë); Vlora (për 5 % të të anketuarve që planifikojnë të migrojnë); Elbasani (për vetëm 2 % prej tyre) dhe 11% e të anketuarve që kanë plan të migrojnë brenda vendit kanë zgjedhur destinacione të tjera urbane si Shkodra, Korça, Pogradeci (figura 2).

Ashtu si studime të tjera rreth migrimit të brendshëm në Shqipëri, edhe rezultatet e anketimit konfirmuan se Tërana përfaqëson destinacionin kryesor të migrimit të brendshëm, duke tërhequr çdo vit individë nga qytetet dhe zonat rurale të vendit.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Kjo pririje është e lidhur ngushtë me rolin që kryeqyteti luan si qendër e zhvillimit arsimor, ekonomik dhe social në vend.

Figura 2: Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “Në cilin qytet planifikoni të largoheni?”



Të anketuarit u pyetën edhe në lidhje me arsyet që i shtynjë ata të planifikojnë largimin drejt një qyteti tjetër. Ekzistojnë shkaqe të ndryshme të migrimit të brendshëm potencial, të cilat lidhen kryesisht me faktorë ekonomikë, shëndetësorë, arsimorë, familjarë etj. Të dhënat e anketës në lidhje me këtë treguan se punësimi dhe arsimimi mbeten faktorët kryesorë shtytës të migrimit të brendshëm. Sipas të dhënave rezultojnë se për 41.5 % të të anketuarve që mendojnë të largohen drejt një qyteti tjetër brenda vendit, arsyeja është shkollimi. 37.6 % e tyre kanë përcaktuar punësimin si arsyen kryesore të planeve për migrim të brendshëm; 8.4 % e tyre e lidhin planin migrator me cilësinë e shërbimeve; 5.6 % e tyre për arsye familjare; 1.9 % e tyre e lidhin planin migrator me shkaqe shëndetësore (Tabela 2).

Tabela 2: Përgjigjet e të anketuarve në lidhje me pyetjen “Cilat janë arsytet pse doni të zhvendoseni në një qytet tjetër? (%)”

Cilat janë arsytet pse doni të zhvendoseni në një qytet tjetër? (%)	
Për arsye shkollimi	45.1
Për arsye punësimi	36.7
Për mundësi më të shumta dhe cilësore në shërbime	8.4
Për t'iu bashkuar fëmijeve	5.6
Për arsye shëndetësore	1.9
Tjetër	2.3
Total	100.0

1.2. Karakteristika të përgjithshme të migrantëve potencial të brendshëm

Në këtë pjesë do të analizohen karakteristikat demografike të migrantëve potencial për të kuptuar se cilët kanë më tepër gjasa të migrojnë drejt qendrave të tjera urbane brenda vendit. Të dhënat e studimit tregojnë se kryesisht janë të rinjtë ata që synojnë të largohen nga Korça drejt një qyteti tjetër, kryesisht Tiranës. 64% e të anketuarve që synojnë të migrojnë brenda vendit i përkasin grupmoshës 18- 24 vjeç; 16% e tyre i përkasin grupmoshës 25- 34 vjeç; 11% e tyre janë të grupmoshës 35- 44 vjeç; 8% e tyre janë të grupmoshës 45- 54 vjeç dhe vetëm 1% e të anketuarve që synojnë të migrojnë brenda vendit i përkasin kategorisë moshore mbi 55 vjeç. Duke analizuar treguesit për variablat ‘grupmosha’, ‘arsyet për t’u larguar’ dhe ‘destinacioni i migrimit’ (tabela 3) konstatohet se të rinjtë e grupmoshës 18- 24 vjeç synojnë të largohen drejt kryeqytetit për arsye të arsimit të tyre.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 3: Krostabulimi i të dhënave për variablat: “grupmosha”; “destinacioni i lëvizjes” dhe “arsyet e zhvendosjes në një qytet tjetër” (%)

Ne cilin qytet planifikoni apo mendoni të zhvendoseni?	Cilat janë arsyet pse doni të zhvendoseni në një qytet tjetër?						Total
	Per arsye punesimi	Per arsye shkollimi	Per arsye shendetesore	Per mundesi me te shumta dhe cilesore ne sherbime	Per t'iu bashkuar femijeve	Tjeter	
18-24 vjec	49.2%	98.6%		35.7%	10.0%		66.7%
25-34 vjec	21.3%		66.7%	35.7%		100.0%	13.0%
Grupmosha 35-44 vjec	19.7%		33.3%	14.3%	30.0%		11%
45-54 vjec	8.2%	1.4%		7.1%	50.0%		7.4%
Mbi 55 vjec	1.6%			7.1%	10.0%		1.9%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sa i takon vendbanimit, të dhënat prej anketimit tregojnë se 50.8% e të anketuarve që synojnë të migrojnë brenda vendit jetojnë në qytet dhe 49.2 % e tyre jetojnë në fshat. Një shpërndarje e tillë e balancuar sa i takon vendbanimit të migrantëve potencialë shpjegohet me prirjen e banorëve për t'u zhvendosur drejt kryeqytetit për arsye që lidhen kryesisht me arsimin, punësimin dhe shërbime më cilësore. Mundësitë në arsimim, punësim apo shërbime që ofron kryeqendra urbane (Tirana), janë faktorë ‘tërheqës’ si për banorët e fshatit ashtu edhe për banorët e zonave urbane të qarkut. Tirana ofron një sërë mundësish krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë, gjë që e bën atë destinacionin kryesor për migrantët e brendshëm. Këto mundësi lidhen me faktorë ekonomikë, arsimorë, shëndetësorë dhe social-kulturorë që e bëjnë jetesën dhe zhvillimin personal më të favorshëm në këtë qytet. Migrimi i brendshëm drejt Tiranës nuk është vetëm pasojë e mungesës së mundësive në zonat e tjera, por sidomos e përqëndrimit të avantazheve konkurruese në kryeqytet.

Anketimi tregoi se migrimi potencial i brendshëm është më i lartë tek femrat (63.8%) sesa tek meshkujt (36.2%). Ky tregues reflekton jo vetëm raportin e përgjithshëm ndërmjet femrave dhe meshkujve të përfshirë në anketim por lidhet kryesisht me faktin se përfshirja më e madhe e vajzave në arsimin e lartë në

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Shqipëri përbën një faktor të drejtpërdrejtë që shpjegon numrin më të madh të vajzave që synojnë të largohen drejt Tiranës për qëllime arsimimi. Sipas të dhënave nga INSTAT, vajzat përbëjnë mbi 60% të studentëve në arsimin e lartë, një prirje që është e qëndrueshme ndër vite (Instat 2024). Kështu, meqenëse më shumë vajza ndjekin arsimin e lartë krahasuar me meshkujt, është e pritshme që ato të përbëjnë edhe shumicën e të rinjve që zhvendosen drejt kryeqytetit për të ndjekur studimet universitare. Kjo lidhje tregon se diferenca gjinore në përfshirjen në arsimin e lartë formëson modelet e migrimit të brendshëm, duke e bërë arsimimin një faktor kyç në lëvizshmërinë urbane të të rinjve, sidomos të vajzave. Një argument i tillë mbështetet edhe nga rezultatet e anketimit. Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘gjinia’ dhe ‘arsyet e zhvendosjes në një qytet tjetër’ tregojnë se 65.6 % e të anketuarve që synojnë të zhvendosen drejt një qyteti tjetër për arsye të shkollimit janë femra dhe vetëm 34.4 % e tyre i përkasin gjinisë mashkullore (tabela 4).

Sa i takon statusit të punësimit të dhënat e anketimit tregojnë se studentët janë më të prirur për të migruar në krahasim me të punësuarit, të vetëpunësuarit apo të papaunët. 62% e të anketuarve që kanë një plan konkret për t’u zhvendosur në një qytet tjetër brenda vendit i përkasin statusit student; 19.7 % e tyre janë të punësuar; 5.6% e tyre janë të vetëpunësuar; 12% e tyre janë të papaunë dhe vetëm 0.7% e tyre janë pensionist/e. Një prirje e tillë mbështetet edhe prej treguesve të sipërpërmendur që e lidhin migrimin potencial të brendshëm të banorëve nga rajoni i Korçës drejt kryeqytetit (për shumicën e të anketuarve) me grupmoshën e të rinjve dhe arsyen kryesore arsimimin.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 4: Krostabulimi i të dhënave për variablat: “grupmosha”; “gjinia” dhe “arsyet e zhvendosjes në një qytet tjetër” (%)

Grupmosha			Cilat janë arsyet pse doni të zhvendoseni në një qytet tjetër?					Total	
			Për arsye punësimi	Për arsye shkollimi	Për arsye shëndetësore	Për mundësi më të shumta dhe cilësore në shërbime	Për t'u bashkuar me femijët		Tjetër
18-24 vjeç	Gjinia	Femër	65.7%	65.6%	100.0%	60.0%		75.0%	65.5%
		Mashkull	34.3%	34.4%		40.0%	100.0%	25.0%	34.5%
	Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
25-34 vjeç	Gjinia	Femër	57.9%	100.0%	100.0%	62.5%			62.5%
		Mashkull	42.1%			37.5%		100.0%	37.5%
	Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%		100.0%	100.0%	100.0%
35-44 vjeç	Gjinia	Femër	46.7%	100.0%	100.0%	50.0%	100.0%		60.9%
		Mashkull	53.3%			50.0%			39.1%
	Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
45-54 vjeç	Gjinia	Femër	55.6%				66.7%		52.9%
		Mashkull	44.4%	100.0%		100.0%	33.3%		47.1%
	Total	100.0%	100.0%		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Mbi 55 vjeç	Gjinia	Femër	100.0%			50.0%	100.0%		75.0%
		Mashkull				50.0%			25.0%
	Total	100.0%			100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Total	Gjinia	Femër	59.5%	66.0%	100.0%	55.6%	75.0%	60.0%	63.7%
		Mashkull	40.5%	34.0%		44.4%	25.0%	40.0%	36.3%
	Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

2. PRIRJET PËR TË EMIGRUAR JASHTË VENDIT

Në këtë pjesë paraqiten të dhënat e anketimit në lidhje me synimet dhe planet për emigrim të banorëve nga rajoni i Korçës, së bashku me identifikimin e faktorëve që çojnë drejt vendimmarrjes për të emigruar, si edhe karakteristikat e emigrantëve potencialë dhe plani i tyre për kthim. Ashtu si u theksua në kapitullin mbi metodologjinë studimi bën dallimin midis variablit ‘përgatitje/plan për të emigruar’ dhe ‘dëshirë për të emigruar’ me qëllim identifikimin sa më saktë të përmasave të migrimit potencial. Studimet tregojnë se ka një dallim ndërmjet dëshirës për të emigruar dhe planit konkret apo synimit për të emigruar. Numri i banorëve që dëshirojnë të largohen mund të jetë më i madh se numri i atyre që planifikojnë të largohen, pasi dëshira jo gjithmonë reflekton mundësinë reale për të migruar. Nga ana tjetër planifikimi apo përgatitja për të migruar mund të mos pasqyrojë domosdoshmërisht dëshirën¹³ por mbetet një tregues më real i migrimit në të ardhmen, pasi mbështetet nga hapa konkrete që shoqërojnë planin migrator të individit. Studimet gjithashtu tregojnë se variabli ‘dëshira për të migruar’ mund të jetë një tregues i pakënaqësisë së përgjithshme të njerëzve me kushtet në vendin e tyre, dhe jo tregues i një qëllimi të vërtetë për të migruar¹⁴. Ky dallim ndërmjet variablave është thelbësor, sepse lidhet me nivelin e angazhimit dhe konkretizimin e veprimit migrator. Duke pasur në konsideratë këtë dallim gjatë anketimit është treguar kujdes i veçantë për të ndarë këto dy variabla për të parashikuar më saktë flukset reale migratore dhe për të kuptuar cilët faktorë ndikojnë në përgatitjen konkrete për emigracion.

2.1. Përmasat e emigrimit potencial nga Shqipëria


Rezultatet prej anketimit rreth përmasave të migrimit potencial, ku individët u pyetën rreth synimeve dhe planeve për t’u larguar nga Shqipëria treguan se 61.5% e të anketuarve mendojnë të largohen nga vendi; 33.5% e tyre mendojnë të emigrojnë por nuk kanë ende një plan konkret, ndërsa 28 % e të anketuarve janë dukë u përgatitur për të emigruar. Të dhënat prej anketimit treguan se vetëm 38.5% e të anketuarve nuk mendojnë të largohen nga vendi (figura 3).

¹³ Gëdeshi & King 2018, Tendencat e reja të migrimit potencial nga Shqipëria, faqe 33

¹⁴ Gallup World Poll 2013- 2016

www.gallup.com/poll/211883/number-potential-migrantsworldwide-tops-700-million.aspx

Figura 3: Përgjigjet e të anketuarve shprehur në përqindje për pyetjen “A po mendoni të largoheni nga Shqipëria?”



Për të krahasuar prirjen për migrim potencial nga Shqipëria përgjatë viteve u referohemi dy studimve të QSES në vitin 2007 dhe 2018. Të dhënat nga QSES rreth prirjeve rajonale për migrim potencial nga Shqipëria tregojnë se në vitin 2007 më të priruar për të emigruar ishin të rinjtë e pakaulifikuar dhe me nivel të ulët arsimor kryesisht nga zona e Korçës, Kukësit dhe Gjirokastrës. Në vitin 2018 migrimi potencial është më i lartë në qarqet Vlorë, Elbasan, Tiranë, Berat dhe më i ulët në qarkun e Kukësit, Korçës dhe Gjirokastrës. Migrimi potencial për qarkun e Korçës në 2018 llogaritej 40.7 %¹⁵. Të dhënat prej studimit tonë treguan një rritje të prirjes për emigrim të banorëve nga rajoni i Korçës në 61.5% përgjatë periudhës 2018- 2025. Krahas tendencës në rritje për emigrim të banorëve nga rajoni i Korçës përgjatë këtyre viteve, vihet në dukje edhe një riorientim i flukseve migratore sa i takon nivelit arsimor të tyre. Të dhënat tregojnë se peshën specifike më të madhe të emigrantëve potencialë e zënë të anketuarit me arsim të mesëm dhe të lartë: 54.8% e aryre që përgatiten të largohen janë me arsim të mesëm dhe 35.6% e tyre kanë arsim të lartë (tabela 5). Edhe % e të anketuarve që mendojnë të largohen pa një plan konkret është e lartë më mesin e banorëve me arsim të lartë. Në një analizë krahasuese me të dhënat e viti 2007 shfaqet një përmbysje e tendencave.

¹⁵ Gëdeshi & King, 2018, Tendencat e reja të migrimit potencial nga Shqipëria, faqe 50

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Nëse në 2007 grupet më të prirura për të emigruar ishin banorët me arsim të ulët nga qarku i Korçës, në 2025 pesha specifike e të anketuarve me arsim të mesëm dhe të lartë që përgatiten apo planifikojnë të emigrojnë është shumë e lartë krahasuar me atë të të anketuarve me arsim të ulët.

Tabela 5: Krostabulimi i të dhënave për variablat: “niveli arsimor” dhe “synimi për të emigruar”

		A po mendoni të largoheni nga Shqipëria?			Total
		Po, kam një plan dhe jam duke u përgatitur	Po, mendoj të largohem por nuk kam një plan konkret	Jo, nuk mendoj të emigroj	
Niveli Arsimor	Arsim i ulët (9-vjecar)	6.7%	9.2%	13.4%	10.1%
	Arsim i Mesëm	54.8%	38.7%	41.7%	44.3%
	Arsim i Lartë	35.6%	47.2%	43.9%	42.7%
	Studime pas universitare	3.0%	4.9%	1.1%	2.9%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


Sigurisht që numri i banorëve të cilët synojnë të largohen është më i lartë se numri i banorëve që emigrojnë. Që migrimi potencial të shndërrohet në migrim real, individët duhet të përmbushin disa kushte të cilat e bëjnë të mundshëm projektin e tyre migrator. Së pari, është e domosdoshme të kenë dokumentacionin përkatës si pasaportë, vizë pune etj. Gjithashtu, duhet të disponojnë burime financiare të mjaftueshme për të mbuluar kostot e udhëtimit dhe jetesës në vendin pritës deri në momentin që sigurojnë të ardhura nga puna. Njohja e gjuhës, informacioni i saktë për realitetin në vendin ku synojnë të vendosen, si dhe ekzistenca e një rrjeti mbështetës – familjarë ose miq që mund të ofrojnë strehim dhe ndihmë për punësim – janë faktorë të rëndësishëm për një fillim të qëndrueshëm. Në disa raste, sigurimi paraprak i një kontrate pune është parakusht për nisjen. Nëse këto kushte nuk plotësohen, ose mungojnë në masë të konsiderueshme, atëherë realizimi i migrimit bëhet shumë më i vështirë, dhe rreziku që ky proces të mos jetë i suksesshëm rritet ndjeshëm.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Për të kuptuar më saktë planet për emigrim të banorëve nga rajoni i Korçës, të anketuarit u pyetën në lidhje me hapat konkretë që janë duke bërë në funksion të projektit të tyre migrator. Prej përgjigjeve të tyre rezultoi se vetëm 15.2% e të anketuarve që planifikojnë të largohen nuk kanë bërë asnjë hap konkret për planin e tyre migrator; 84.8 % e tyre kanë bërë hapa konkretë dhe specifikisht:

- 20.5% e tyre kanë familjarë/ të afërm/ miq që po i ndihmojnë për të konkretizuar planin migrator
- 15.5% e tyre kanë marrë ofertë pune
- 13.8% kanë aplikuar për studime
- 10.1% e tyre kanë aplikuar për vizë/pasaportë
- 18.5% e tyre janë në fazë informimi rreth mundësive dhe mënyrës për të realizuar projektin migrator
- 5.1% e tyre janë duke mësuar/çertifikuuar gjuhën
- dhe 1.3% e tyre kanë grumbulluar të ardhurat e nevojshme për të përballuar jetesën në vendin pritës në fazën e parë të migrimit (figura 4).

Figura 4 : Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen “A keni bërë ndonjë hap konkret për të emigruar?”



Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Të dhënat e paraqitura në figurën 4 ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi shkallën e konkretizimit të synimit për emigrim në mesin e të anketuarve. Rreth 84.8% e tyre kanë ndërmarrë të paktën një hap konkret në funksion të emigrimit, çka tregon se për një pjesë të konsiderueshme të banorëve, migrimi nuk mbetet vetëm një dëshirë, por shoqërohet me veprime të planifikuara dhe të qëllimshme. Duke analizuar të dhënat e mësipërme vihet në dukje se rrjetet sociale ndikojnë në shkallë të gjerë, jo vetëm në integrimin e migrantëve në vendin pritës, por edhe në marrjen e vendimit për të migruar në fazën paramigratore. 20.5% e të anketuarve që përgatiten të emigrojnë shprehen se të afërmit apo familjarët e tyre në emigracion po i ndihmojnë në realizimin e projektit migrator. Ky është një tregues domethënës sa i takon ndikimit që kanë rrjetet sociale në vendimarrjen për të emigruar, pasi lidhjet ndërpersonale ndikojnë në uljen e kostove dhe pasigurisë së migrimit. Në kontekstin e migracionit shqiptar si të brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm rrjetet sociale përfshijnë lidhje sociale me bazë familjare/ fisnore apo miqësore përmes të cilave migrantët e rinj sigurojnë një bazë për vendosjen dhe qëndrimin në vendin e destinacionit veçanërisht në fillim të përvojës migratore.

Gjithashtu rezultatet treguan se 18.5% janë në fazën e informimit, duke kërkuar të dhëna dhe mundësi rreth emigrimit, ndërsa 15.5% kanë marrë një ofertë pune, një tregues i rëndësishëm i kanalizimit të migrimit përmes mekanizmave ekonomikë dhe formalë të punësimit jashtë vendit. Ky tregues i fundit mbështet konstatimet e literaturës mbi migrimin ekonomik si formë dominuese për vendet në zhvillim. Në vijim, 13.8% e të anketuarve që përgatiten për të emigruar kanë aplikuar për studime, duke sugjeruar që arsimit mbetet një rrugë kyçe drejt migrimit, sidomos për të rinjtë. Ndërkohë, 10.1% kanë aplikuar për vizë ose pasaportë të huaj, një tjetër tregues i vendosmërisë për të realizuar lëvizjen. Përgatitja përmes mësimit të gjuhës së huaj (5.1%) dhe grumbullimit të fondeve (1.3%) janë më pak të përhapura, por gjithsesi dëshmojnë për përgatitje konkrete, ndonëse ndoshta më individuale dhe afatgjata. Këto të dhëna sugjerojnë se migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës është në një fazë të avancuar për shumë individë, me një shumicë që kanë kaluar nga qëllimi në veprim. Rrjetet sociale, mundësitë për punë apo studim, dhe angazhimet për të marrë dokumentacionin përkatës përbëjnë kanalet më të rëndësishme për realizimin e emigrimit. Këto gjetje nxisin nevojën për politika që adresojnë jo vetëm shkaqet strukturore të synimit për emigrim, por edhe krijimin e alternativave tërheqëse brenda vendit për të frenuar këtë trend në rritje.

Kur planifikojnë të emigrojnë?

Variabli kohë merr rëndësi të veçantë në analizat dhe studimet rreth migracionit si në kontekstin e kohës së planifikuar për të emigruar ashtu edhe në kohëzgjatjen e projektit migrator. Veçanërisht identifikimi i kohës kur planifikojnë të largohen migrantët potencialë mbetet një tregues i rëndësishëm për të analizuar impaktet e migrimit për rajonin në të ardhmen dhe mundësitë e projektimit të politikave për menaxhimin e pasojave të kësaj dukurie. Gjithashtu koha e planifikuar për të realizuar planin migrator është një tregues që lejon të përforcojmë analizën për konkretizimin e planit migrator të të anketuarve dhe mundësisë që migrimi potencial të shndërrohet në migrim real. Në këtë kuadër të anketuarit u pyetën se kur planifikojnë apo përgatiten të largohen nga vendi. Të dhënat prej anketës paraqiten në tabelën 6. Gjetjet prej studimit treguan se shumica e migrantëve potencialë kanë plan të largohen brenda një periudhë të shkurtër kohore: 37.5% e migrantëve potencial planifikojnë të emigrojnë brenda një viti dhe 31.6% gjatë 3 viteve të ardhshme. Këto rezultate tregojnë një ndjeshmëri të lartë ndaj kushteve aktuale dhe një vendosmëri për ndryshim të shpejtë. Ndërkohë 23.4% e migrantëve potencial planifikojnë të emigrojnë brenda 5 viteve të ardhshme. Kjo mund të përfshijë individë që kanë nevojë të mbarojnë një cikël studimi, të kursejnë më shumë para, të pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm, apo të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale/gjuhësore, etj. Ndërsa një pjesë e vogël (7.6%) e shohin emigrimin si një perspektivë më afatgjatë, pasi mendojnë të emigrojnë gjatë 10 viteve të ardhshme. Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë qartë se emigrimi për shumicën e të anketuarve që e kanë në plan, nuk është një dëshirë abstrakte, por një strategji urgjente dhe konkrete, që do të realizohet brenda pak vitesh, shumica brenda një viti. Kjo tregon një potencial të lartë për lëvizje demografike, që mund të ketë pasojë të konsiderueshme në tregun e punës, strukturën sociale dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Tabela 6 : Migrantët potencialë sipas kohës kur planifikojnë të emigrojnë (%)

Koha e planifikuar për të migruar	%
Brenda vitit të parë	37.5
Gjatë 3 viteve të ardhshme	31.6
Gjatë 5 viteve të ardhshme	23.4
Gjatë 10 viteve të ardhshme	7.6
Total	100.0

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Për të kuptuar më tej intensitetin dhe stadin e procesit migrator analizojmë ndërlidhjen mes kohës së planifikuar për të emigruar dhe nivelit të konkretizimit të planit migrator nga ana e të anketuarve (tabela 7).

Tabela 7: Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘konkretizimi i planit migrator’ dhe ‘koha’ kur planifikojne të emigrojnë (%)

		Kur planifikoni të emigroni?				Total
		Brenda vitit	Gjatë 3 viteve te ardhshme	Gjatë 5 viteve te ardhshme	Gjatë 10 viteve te ardhshme	
A keni bërë ndonjë hap konkret për të emigruar?	Kam marrë oferte pune	21.1%	17.4%	7.4%	4.5%	15.5%
	Kam aplikuar për studime	24.8%	13.0%			13.4%
	Kam aplikuar për vize/pasaporte të huaj	11.9%	10.9%	10.3%		10.3%
	Jam duke mësuar/certifikuar gjuhën	6.4%	4.3%	5.9%		5.2%
	Kam grumbulluar mjaftueshëm para për të emigruar	2.8%	1.1%			1.4%
	Kam të afërm/miq që po me ndihmojne për të emigruar	21.1%	20.7%	22.1%	18.2%	21.0%
	Jam ende në fazen e informimit	6.4%	21.7%	32.4%	27.3%	18.9%
	Nuk kam bërë asnjë hap konkret	5.5%	10.9%	22.1%	50.0%	14.4%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	

Për ata që planifikojnë të emigrojnë brenda një viti, dallohen përqindje të larta të veprimeve konkrete: 24.8% kanë aplikuar për studime dhe 21.1% kanë marrë ofertë pune, që janë tregues të një angazhimi institucional. 21.1% kanë të afërm të cilët po i ndihmojnë për të emigruar dhe 11.9% kanë aplikuar për viza/pasaportë të huaj, ndërsa 6.4% janë duke mësuar gjuhën, që nënkupton gatishmëri dhe afërsi me nisjen.

Për këtë grup, migrimi është projekt i strukturuar dhe në fazë të avancuar, shpesh i lidhur me mundësi reale punësimi apo studimi. Të dhënat tregojnë një nivel të lartë vendosmërie dhe akses ndaj burimeve (rrjete sociale, oferta pune, aplikime etj).

Sa i takon grupit të të anketuarve që planifikojnë të emigrojnë gjatë 3 dhe 5 viteve të ardhshme vihet në dukje se 17.4% e atyre që planifikojnë të largohen brenda 3 viteve kanë marrë ofertë pune.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Një përqindje të konsiderueshme për këtë grupim zënë të anketuarit të cilët kanë të afërm/miq në emigracion, që po i ndihmojnë të realizojnë projektin e tyre migrator: 20.7% e tyre planifikojnë të largohen brenda 3 viteve dhe 22.1% e tyre brenda 5 viteve të ardhshme. Gjithshtu ka një % të lartë të të anketuarve që janë ende në fazën e informimit dhe synojnë të largohen brenda gjatë 3 viteve të ardhshme (21.7%) dhe 5 viteve të ardhshme (32.4%).

Sa i takon të të anketuarve që kanë një ide të largët për emigrim dhe planifikojnë të largohen gjatë 10 viteve të ardhshme dallohet një mungesë e përpjekjeve për konkretizim të planit migrator: 50.0% e tyre nuk kanë bërë asnjë hap konkret dhe 27.3% janë ende në fazën e informimit. Ky është një grup që e percepton migrimin si mundësi në të ardhmen, por nuk ka përfshirje reale e aktuale në përgatitje.

Në një analizë më të detajuar të të dhënave të mësipërme argumentohet se migrantët me plane të afërta për të emigruar kanë akses më të madh në tregun ndërkombëtar të punës. Largimi i menjëhershëm lidhet shpesh me punësim të siguruar. Ndërsa emigrimi për studime është më i përqendruar tek ata që synojnë largim të shpejtë. Rrjetet sociale mbeten shumë të rëndësishme duke ofruar mbështetje kryesore në të gjitha fazat e planifikimit dhe duke kompensuar mungesën e resurseve institucionale tek disa grupe. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm është e pranishme në të gjitha grupet, por më e theksuara te grupet që kanë plane për të emigruar nga 1 deri 5 vitet e ardhshme. Po ashtu certifikimi gjuhësor është element mbështetës për migrim për të njëjtin grup të anketuarsish. Rezultatet treguan se përgatitja financiare është shumë e kufizuar, duke sugjeruar barrierë ekonomike për shumë migrantë, sidomos ata me plane më të largëta. Faza e informimit rritet ndjeshëm në grupet me plane më të vonshme, duke treguar pasiguri, mungesë përgatitjeje, ose projekt të largët e jo të strukturuar.

Duke përmbledhur sa më lart konstatohet se sa më afatshkurtër plani migrator aq më i konkretizuar është ai. Pra ka një lidhje ndërmjet kohës së planifikuar për migrim dhe konkretizimit të planit migrator. Këtë e tregon edhe testi Chi-Square për këto variabla, vlera e të cilit tregon se ka një lidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet variablave: $\chi^2(21, N = 294) = 82.338, p = .000 < .05$.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 8: Rezultatet e testit hi- katror për lidhjen ndërmjet variablave: 'koha kur planifikojnë të largohen'dhe 'konkretizimi i planit migrator'

	Vlera	Shkallët e lirisë	p
Hi-katror i Pearson-it	82.338 ^a	21	.000
Raporti i përngjasisë	93.475	21	.000
Bashkëshoqërimi linear	56.171	1	.000
Numri i rasteve të vlefshme	294		


2.2 Karakteristika demografike dhe socio-ekonomike të emigrantëve potencial

Kjo pjesë ofron të dhëna dhe analiza rreth profilit të banorëve që planifikojnë dhe përgatiten të emigrojnë, duke u fokusuar në faktorë si moshë, gjinia, niveli arsimor, statusi i punësimit, të ardhurat, prirjet lokale etj. Kjo analizë ndihmon në identifikimin e grupeve më të prekura nga migrimi potencial dhe faktorët që i shtojnë drejt këtij vendimi. Përmes kësaj qasjeje, synohet të kuptohet më mirë dinamika e migrimit potencial në banorëve nga rajoni i Korçës dhe të kontribuohet në hartimin e politikave sociale dhe zhvillimore më të përshtatshme.

Migrimi potencial dhe grupmosha

Treguesit demografikë në lidhje me migrimin potencial nga Shqipëria të të anketuarve në rajonin e Korçës tregojnë se përgjithësisht të rinjtë janë ata që synojnë të emigrojnë (figura 5) dhe me rritjen e moshës ka një rënie të treguesve për migrim potencial. Konkretisht 49.6% e të anketuarve të grupmoshës 18- 24 vjeç janë duke u përgatitur për të emigruar dhe 46.6 % e tyre mendojnë të emigrojnë. 17.8% e të anketuarve të grupmoshës 25- 34 vjeç janë duke u përgatitur për të emigruar dhe 20.2% e tyre synojnë te emigrojnë. 17.8% e të anketuarve të grupmoshës 35- 44 vjeç po përgatiten për të emigruar dhe 19.6% e tyre mendojnë të emigrojnë. Të dhënat tregojnë se synimi për të emigruar ulet për grupmoshat mbi 44 vjeç. Këto rezultate mbështesin edhe gjetjet e studimeve të tjera rreth migrimit potencial të të rinjve nga Shqipëria.


Figura 5: Grafiku i krostabulimit të të dhënave për variablat: “grupmosha” dhe “synimi për të emigruar”



Migrimi potencial dhe gjinia

Në lidhje me prirjen për migrim potencial sipas përkatësisë gjinore treguesit statistikorë tregojnë se migrimi potencial është më i madh tek femrat sesa tek meshkujt (figura 6). Një tregues i tillë lidhet së pari me përqindjen më të madhe të të anketuarve femra të përfshirë në studim (59.2% femra dhe 40.8% meshkuj është raporti gjinor i banorëve të përfshirë në studim). Gjithashtu ky tregues reflekton edhe përfshirjen më të madhe të grave në projektin migrator (kryesisht për arsye arsimimi, apo punësimi) sidomos në dekadën e tretë të emigrimit modern shqiptar. Studimet tregojnë se emigrimi modern shqiptar në dekadën e parë ka qenë kryesisht mashkullor. Pjesëmarrja e grave në emigracion u rrit pas viteve 2000, veçanërisht në kuadrin e ribashkimit familjar dhe punës në sektorë si shërbimet, kujdesi shëndetësor dhe shtëpiak (Vullnetari 2012; IOM 2007;). Të dhënat nga IOM dhe UNDP tregojnë për një tendencë drejt balancimit gjinor në emigrim, sidomos pas viteve 2010 (IOM 2018; UN Women & UNDP Albania 2020).

Figura 6: Migrimi potencial sipas përkatësisë gjinore të të anketuarve



Migrimi potencial sipas nivelit arsimor

Studimet tregojnë se ekziston një ndërlidhje mes arsimimit dhe synimit për të migruar. Të dhënat empirike dhe studimet e kohëve të fundit tregojnë se individët me nivel të lartë arsimimi (arsimi i mesëm i lartë dhe arsimi universitar) kanë një prirje më të lartë për të shprehur interes për migrim, krahasuar me ata me arsim të ulët. Kjo lidhet me një sërë faktorësh si:

- Mungesa e mundësive të punësimit në përputhje me kualifikimet në tregun vendas të punës, që i shtyn profesionistët e rinj të kërkojnë alternativa në vende të zhvilluara si të Evropës Perëndimore
- Aspiratat për një jetë më cilësore, të lidhura me mirëqenie ekonomike, siguri sociale dhe zhvillim profesional, i motivojnë të rinjtë e arsimuar të planifikojnë migrimin afatgjatë
- Mundësitë për studime të mëtejshme dhe specializime jashtë vendit janë gjithashtu një arsye e fortë, veçanërisht për studentët dhe të diplomuarit e rinj.


Nga ana tjetër arsimimi shërbën si një faktor nxitës dhe lehtësues për realizimin e projektit migrator. Aftësitë gjuhësore, kompetencat profesionale dhe njohja me sisteme ndërkombëtare e bëjnë më të thjeshtë përshtatjen dhe integrimin në

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

tregjet e huaja të punës. Në këtë kuptim, të rinjtë e arsimuar jo vetëm që kanë më shumë motivim për të migruar, por edhe më shumë mjete për ta bërë këtë në mënyrë të suksesshme dhe ligjore. Kjo është veçanërisht e lidhur ngushtë edhe me kriterin për sigurimin e një kontrate pune në vendet e zhvilluara, si një ndër hapat më të rëndësishëm për realizimin me sukses të projektit migrator.

Sa i takon ndërlidhjes mes arsimimit dhe prirjes së banorëve për të emigruar të dhënat prej anketimit treguan se migrimi potencial është më i lartë te individët me arsim të mesëm dhe të lartë (universitar). Kështu 54.8% e atyre kanë një plan konkret dhe janë duke u përgatitur për migrim dhe 38.7% që mendojnë të emigrojnë kanë arsim të mesëm. Po ashtu të dhënat tregojnë se personat me arsim të lartë universitar shfaqin gjithashtu interes të lartë për migrim: 47.2% e të anketuarve me arsim të lartë mendojnë të largohen, por nuk kanë plan konkret dhe 35.6% e tyre janë në proces përgatitor (figura 7). Interes më i ulët për migrim shfaqet te personat me arsim të ulët dhe pasuniversitar. Vetëm 9.2% e atyre me arsim 9-vjeçar kanë menduar të largohen dhe 6.7% janë duke u përgatitur. Po ashtu, te grupi me studime pasuniversitare, përqindjet janë shumë të ulëta: 4.9% (pa plan konkret) dhe 3.0% (në përgatitje). Këta tregues mund të shpjegohen me faktin se të anketuarit me arsim të lartë pasuniversitar kanë më shumë angazhime profesionale dhe shanse brenda vendit, ndërsa ata me arsim të ulët (9 vjeçar) kanë më pak burime, njohuri, ose mundësi për të migruar.

Figura 7: Migrimi potencial dhe arsimimi



Një studim i vitit 2007 rreth migrimit potencial të të rinjve nga Shqipëria tregoi se sa më i ulët ishte niveli arsimor aq më e lartë ishte dëshira për migrim. Kjo shpjegohej me faktin se njerëzit e paarsimuar dhe të pakualifikuar ishin të papunë ose kishin vështirësi në gjetjen e një pune në Shqipëri dhe dëshironin të emigronin¹⁶. Ndërkohë të dhënat prej QSES për migrimin potencial të të rinjve nga Shqipëria në vitin 2018 treguan një rezultat të përmbysur, ku tendenca më e madhe për migrim potencial shfaqej në mesin e banorëve me arsim të mesëm dhe të lartë. Gjetjet prej studimit tonë konfirmojnë të njëjtën prirje për migrim potencial të të anketuarve me arsim të mesëm dhe arsim universitar. Kjo shpjegohet nga njëra anë me mundësitë më të mëdha për punësim që ofrohen për personat e arsimuar dhe të kualifikuar në shtetet më të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Në kushtet e një tregu global gjithnjë e më konkurrues, vendet e zhvilluara synojnë të tërheqin profesionistët më të përgatitur, që mund të kontribuojnë në forcimin e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së tyre afatgjatë. Nga ana tjetër përfshirja e njerëzve të kualifikuar dhe të arsimuar në emigrim mund të jetë edhe një tregues i pakënaqësisë që kanë banorët me këtë status arsimor ndaj mundësive të punësimit dhe perspektivës së qëndrueshme në Shqipëri.


Migrimi potencial dhe statusi i punësimit

Të dhënat e paraqitura në figurën 8 ofrojnë një pamje të qartë të lidhjes midis pozicionit të individëve në tregun e punës dhe prirjes së tyre për migrim. Rezultatet tregojnë se studentët, të punësuarit dhe të papunët përfaqësojnë grupet më të prirura për të migruar, si në nivelin e synimit për migrim, ashtu edhe në fazën e përgatitjes konkrete.

Më konkretisht, 38% e studentëve deklarojnë se mendojnë të largohen, ndërsa një përqindje thujtë e barabartë (38.1%) është në fazë të avancuar përgatitore për migrim. Kjo e vendos këtë kategori në krye të listës për migrim potencial. Edhe individët e punësuar me kohë të plotë shfaqin një përqindje domethënëse migrimi potencial: 20.1% e të punësuarve me kohë të plotë dhe 17.2% e të punësuarve me kohë të pjesëshme janë duke u përgatitur për të emigruar.

¹⁶ European Training Foundation (2007). The Contribution of Human Resources Development to Migration Policy in Albania. Torino: ETF.

Figura 8: Migrimi potencial sipas statusit të punësimit të të anketuarve




Po ashtu një përqindje e konsiderueshme e të punësuarve deklarojnë se po mendojnë të emigrojnë (25.2% e të punësuarve me kohë të plotë dhe 10.4% e të punësuarve me kohë të pjesëshme). Në mënyrë të ngjashme, të papunët raportojnë një nivel të lartë të interesit për migrim, me 19.4% që janë duke u përgatitur për të emigruar dhe 18.4% që mendojnë të emigrojnë. Këto rezultate mund të reflektojnë ndoshta pakënaqësinë me kushtet aktuale të punës apo mungesën e perspektivës afatgjatë. Për të kuptuar prirjen e migrantëve potencial me status i/e punësuar dhe nivelin e kënaqësisë/ pakënaqësisë ndaj tregut të punës (mundësitë për punsim dhe pagat) i referohemi treguesve në figurën 9. Për të nxjerrë në pah lidhjen mes këtyre variablave janë selektuar të gjithë personat që janë duke u përgatitur dhe kanë plan të emigrojnë jashtë Shqipërisë të cilët statusin e punësimit e kanë: i/e punësuar me kohe të plotë; i/e punësuar me kohë të pjesëshme dhe i vetëpunësuar. Për këtë kategori të anketuarish është matur niveli i kënaqësisë apo pakënaqësisë që kanë këta individë ndaj tregut të punësimit në vend. Nga të dhënat në figurën 9 vihet re se 14,4% janë aspak të kënaqur me tregun e punës; 38,6% janë të pakënaqur me tregun e punës; 27,5% janë neutral; 13,1% janë të kënaqur dhe vetëm 6,4% janë shumë të kënaqur. Vihet re se 53% e të anketuarve me status i/e punësuar, të cilët po përgatiten për të emigruar janë aspak të kënaqur ose të pakënaqur nga tregu i punës (mundësitë për punësim dhe pagat).

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Kjo tregon se pakënaqësia me pagat dhe mundësitë e punës është një nga shtysat kryesore që shtyn të punësuarit drejt planifikimit për të migruar. Nga ana tjetër shifrat që tregojnë se një pjesë e të punësuarve që mbajnë qëndrim neutral (27.5%) ose janë të kënaqur (19.5%) me tregun e punës, megjithatë shprehin dëshirën për të emigruar, kanë një domethënie të veçantë në analizën e tendencave migratore. Kjo prirje tregon se vendimi për migrim nuk lidhet domosdoshmërisht vetëm me pakënaqësinë ndaj mundësive për punësim dhe nivelin e pagave, por përfshin një spekter më të gjerë faktorësh strukturorë dhe socialë. Pra migrimi shihet si një strategji për përmirësimin e të ardhmes dhe jo vetëm si reagim ndaj kushteve aktuale të tregut të punës.

Figura 9: Kënaqësia/pakënaqësia ndaj tregut të punës për migrantët potencial me status i/e punësuar



* me status i/e punësuar përfshihen të gjithë të anketuarit që janë duke u përgatitur për të emigruar të cilët janë të punësuar me kohë të plotë; të punësuar me kohë të pjesësme dhe të vetëpunësuar


Përqindja e lartë e të rinjve të arsimuar dhe të punësuarve që duan të largohen (figura 8) mund të shpjegohet përmes *teorisë së faktorëve "shtytës dhe tërheqës"* (Lee 1966; Massey et al 1993; Castels S & Miller 2003) ku, pasiguria ekonomike dhe mungesa e perspektivës në vend shërbejnë si faktorë shtytës nga njëra anë dhe mundësitë më të mëdha për punësim të qëndrueshëm, kushte më të mira jetese

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

dhe siguri sociale shërbejnë si faktorë tërheqës për migrantët potencialë. Nga ana tjetër *teoria e kapitalit njerëzor* (Becker 1962 & Schultz 1961; Coleman 1990; Bourdieu 1986) sugjeron se individët investojnë në migrim për të maksimizuar kthimin mbi kapitalin e tyre njerëzor – njohuritë, aftësitë dhe kualifikimet e fituara përmes arsimit dhe eksperiencës. Migrimi shihet si një investim i kapitalit njerëzor, ku individët ose familjet zgjedhin të emigrojnë për të rritur potencialisht të ardhurat e tyre të ardhshme ose për të përmirësuar standardet e tyre të jetesës. Në këndvështrimin e kësaj teorie mund të argumentohet se studentët dhe të rinjtë e arsimuar, të cilët ende nuk janë stabilizuar në tregun vendas të punës, synojnë të emigrojnë për të përfituar nga tregje më konkurruese dhe me mundësi më të mëdha karriere.

Migrimi potencial dhe statusi familjar

Figura 10: Migrimi potencial dhe statusi familjar




Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Të dhënat prej anketimit treguan se migrimi potencial është më i lartë te të anketuarit e pamartuar (shumica e të cilëve i përkasin grupmoshës 18- 24 vjeç që synojnë të emigrojnë për arsye arsimimi). Po ashtu ka një përqindje të konsiderueshme të të anketuarve që planifikojnë të emigrojnë me statusin familjar i/e martuar, të cilat i përkasin kryesisht grupmoshës 35- 44 vjeç dhe mbi 45 vjeç.

Migrimi potencial sipas të ardhurave në familje

Prirja për migrim nuk është më vetëm një karakteristikë e grupeve me të ardhura të ulta të shoqërisë por karakterizon edhe grupime shoqërore që renditen në nivelin e të ardhurave mesatare. Të dhënat prej anketimit rreth migrimit të mundshëm të banorëve nga qarku i Korçës sipas të ardhurave në familje treguan se nivelin më të ulët të migrimit potencial e kanë banorët që i përkasin kategorive skajore (individë që jetojnë në minimumin jetik dhe atyre me të ardhura mbi mesatare). Të dhënat e paraqitura në figurën 11 reflektojnë një marrëdhënie komplekse midis kushteve ekonomike dhe vendimmarrjes për migrim.

Figura 11: Migrimi potencial sipas të ardhurave familjare të të anketuarve



Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Konkretisht gjetjet prej anketimit tregojnë se grupet me të ardhura mesatare (70,001 – 100,000 lekë)¹⁷ janë më të prirura për të emigruar: 31.5% e individëve me këtë nivel të ardhurash janë duke u përgatitur për të emigruar, çka përbën përqindjen më të lartë në të gjithë kategoritë; 28.8% e të anketuarve me këtë nivel të ardhurash deklarojnë se mendojnë të emigrojnë por ende nuk kanë ndërmarrë një hap konkret. Kjo kategori socio- ekonomike shfaqet më aktive në përgatitjen dhe planifikimin e migrimit, ndoshta për shkak të ndërgjegjësimit më të madh për mundësitë jashtë vendit, por edhe për shkak të mungesës së perspektivës për përmirësim ekonomik afatgjatë në Shqipëri.

Rezultatet e anketimit gjithashtu tregojnë se migrimi potencial mbetet i lartë edhe tek familjet me të ardhura nën mesatare (40,001–70,000 lekë), ku 26.4% mendojnë të largohen dhe 23.1% janë në përgatitje të projektit migrator. Kjo pasqyron faktin se vështirësitë ekonomike dhe pasiguria sociale janë faktorë shtytës të fortë për migrim.

Grupet me të ardhura shumë të ulëta (minimum jetik) dhe shumë të larta kanë më pak interes për migrim. Ata që mbështeten te ndihma ekonomike apo pensioni social përfaqësojnë grupin më pak të interesuar. Edhe familjet me të ardhura mbi mesatare tregojnë nivel më të ulët për migrim potencial. Këto rezultate tregojnë se individët apo familjet që kanë të ardhura shumë të ulta apo jetojnë në varfëri e kanë të vështirë të migrojnë sepse ju mungojnë burimet financiare, humane dhe sociale të nevojshme për të realizuar projektin migrator. Ndërsa ata që kanë të ardhura të larta, mbi mesatare kanë më pak arsye për të migruar dhe gëzojnë më shumë stabilitet.

Duke përmbledhur sa më lart grafiku tregon se migrimi potencial është më i theksuar në mesin e familjeve me të ardhura mesatare dhe nën mesatare, të cilat përfaqësojnë një klasë sociale në tranzicion, me aspirata për përmirësim dhe vetëdije për kufizimet strukturore në vend. Ndërkohë, individët nga skajet më të ulëta ose më të larta të spektrit ekonomik janë më pak të përfshirë në planet për migrim, për arsye të kufizimeve praktike ose të kënaqësisë me situatën ekzistuese. Këto rezultate mbështesin idenë dhe gjetjet e studimeve të ngjashme se aktualisht migracioni shqiptar realizohet nga individë dhe familje që kanë mjaftueshëm burime për të mbuluar koston fillestare të migrimit dhe presin përfitime më të mëdha ekonomike në vendin e destinacionit.

¹⁷ Klasifikimi për të ardhurat familjare i referohet treguesve të INSTAT në lidhje me nivelin minimal dhe mesatar të pagave në Shqipëri për 2024. Shih Instat, Statistikat e pagave, tremujori i IV 2024, <https://www.instat.gov.al/media/14984/statistikat-e-pagave-tremujori-iv-2024.pdf>


Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Nga ana tjetër në këndvështrimin e teorisë së faktorëve “shtytës dhe tërheqës” argumentohet se individët me të ardhura të mesme ndodhen në një pozitë ku faktorët shtytës (pasiguria dhe kufizimet në rritjen ekonomike) kombinohen me aftësinë reale për të reaguar ndaj faktorëve tërheqës (punësim, mirëqenie, siguri) në vendet pritëse.

Migrimi potencial sipas vendbanimit

Sa i takon prirjes së banorëve nga rajoni i Korçës për të emigruar, sipas vendbanimit rezulton se përqindja më e madhe e migrantëve potencialë banojnë në qytet: 61.2% e të anketuarve që janë duke u përgatitur për të emigruar dhe 48.8% e të anketuarve që mendojnë të emigrojnë jetojnë në qytet (figura 12). Ndërsa migrantët potencialë me vendbanim në fshat zënë një përqindje me të ulët: 38.8% e tyre janë duke u përgatitur për të emigruar dhe 51.2% e tyre mendojnë të emigrojnë. Ky raport nuk është tregues i ndonjë lidhje domethënëse ndërmjet vendbanimit dhe prirjes për migrim të banorëve, por mund të shpjgohet me përfshirjen më të madhe në anketim të banorëve me vendbanim në qytet (konkretisht 54.3 % e banorëve të përfshirë në anketim jetojnë në qytet dhe 44.4 % e tyre jetojnë në fshat). Edhe pse treguesi nuk është domethënës sa i takon prirjes për migrim, ai merr rëndësi në funksion të analizës së pasojave të mundshme të migrimit si për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale.


Figura 12: Migrimi potencial sipas vendbanimit të të anketuarve



Migrimi potencial sipas bashkive

Figura 13 paraqet përqindjen e individëve në çdo bashki të qarkut të Korçës që kanë shprehur interes për migrim, të ndarë në dy kategori: ata që janë duke u përgatitur për të emigruar dhe ata që mendojnë të emigrojnë (por pa një hap konkret). Të dhënat e paraqitura në grafik tregojnë një nivel të lartë të migrimit potencial në disa bashki të qarkut Korçë, me dallime të dukshme midis tyre: Korça, si bashkia më e madhe urbane, shfaq përqindje të larta në të dy kategoritë, me një balancë të qëndrueshme midis atyre që po përgatiten për t'u larguar (35.6%) dhe atyre që mendojnë të largohen pa plan konkret (35.0%). Kjo tregon një potencial të lartë për migrim real në të ardhmen e afërt.

Figura 13: Migrimi potencial sipas bashkive përkatëse të qarkut Korçë



Pogradeci është bashkia me nivelin më të lartë të individëve që mendojnë të largohen pa pasur një plan konkret (37.4%), ndërsa 26.7% janë në faza përgatitore për migrim. Kjo sugjeron një përhapje të gjerë të dëshirës për migrim në nivele të ndryshme të vendimmarrjes. Në Devoll, 23% e të anketuarve kanë një plan konkret migrimi, ndërsa vetëm 12.3% mendojnë të largohen, çka tregon një nivel më të lartë të gatishmërisë reale për t'u larguar.

Bashkitë më të vogla si Erseka, Maliqi dhe Pusteci raportojnë një përqindje dukshëm më të ulët të interesit për migrim. Megjithatë, edhe këtu vihet re një prirje për reflektim mbi largimin, sidomos në Maliq ku rreth 12% janë në përgatitje për migrim. Ky grafik dëshmon se migrimi potencial është një fenomen i përhapur në gjithë qarkun, me intensitet më të lartë në zonat urbane si Pogradeci dhe Korça. Ndërsa në zonat më periferike dhe rurale ka më pak planifikim aktiv për migrim, çka mund të lidhet me mungesën e burimeve për të ndërmarrë një hap të tillë, por gjithsesi ekziston një prirje për largim në të ardhmen. Ky informacion është thelbësor për hartimin e politikave rajonale për parandalimin e depopullimit dhe mbështetjen e qëndrueshmërisë lokale.

2.3. Faktorë shtytës /tërheqës të emigrimit potencial

Migrimi potencial nga Shqipëria është një fenomen kompleks dhe shumëdimensional, i ndikuar nga një sërë faktorësh ekonomik, social dhe institucionalë. Në thelb të këtij procesi qëndrojnë dy grupe motivimesh: faktorët “shtytës”, të cilët nxisin individin të largohet nga vendi i origjinës, dhe faktorët “tërheqës”, që lidhen me mundësitë dhe përfitimet e pritshme në vendin e destinacionit. Papunësia, pagat e ulëta, pasiguria ekonomike, mungesa e mundësive për zhvillim profesional apo arsim cilësor shpesh përmenden si shtysa kryesore për largim (Instat 2022; QSES 2018;). Nga ana tjetër, vendet e huaja perceptohen si hapësira me kushte më të mira jetese, stabilitet ekonomik, sisteme të zhvilluara të arsimit dhe shëndetësisë, si dhe mundësi për integrim social e profesional. Veçanërisht vendet e zhvilluara të Evropës perëndimore dhe SH. B. A ofrojnë mundësi më të mira punësimi, paga më të larta, kushte më të mira jetese, dhe një mjedis më të sigurt social e institucional (Gallup 2015; IOM 2020). Qëllimi për të emigruar lidhet ngushtë me mënyrën se si individët e imagjinojnë të ardhmen e tyre, dhe veçanërisht të fëmijëve të tyre. Ai pasqyron, nga njëra anë, realitetin ekonomik, social dhe politik të vendit të origjinës, ndërsa nga ana tjetër, reflekton perceptimin për mundësitë dhe përmirësimin e jetës në vendin pritës. Në vijim do të paqariten të dhënat prej anketimit, të cilat hedhin dritë mbi mënyrën se si këto faktorë përjetohen dhe vlerësohen nga banorët, duke ndihmuar në kuptimin më të thelluar të prirjeve migratore në vend.


Arsyet që lidhen me synimin për të emigruar

Synimi për të emigruar është një vendim kompleks, i ndikuar si nga përvojat dhe aspiratat personale, ashtu edhe nga konteksti më i gjerë ekonomik, social dhe kulturor në të cilin individët jetojnë.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Nga njëra anë, ndjenja e mungesës së perspektivës, pakënaqësia me cilësinë e jetës, ose dëshira për një të ardhme më të sigurt dhe të realizuar shpesh burojnë nga përjetime subjektive dhe pritshmëri individuale. Nga ana tjetër, faktorët strukturorë, socio- ekonomike të ndërthurur me normat kulturore, modelet e suksesit dhe praktikët e përhapura të migrimit në shoqërinë shqiptare luajnë rol në legjitimimin e migrimit si rrugë e pranueshme dhe shpesh e dëshirueshme për realizimin personal. Kjo pjesë synon të shqyrtojë arsyet që nxisin individët të orientojnë mendimin dhe veprimet e tyre drejt emigrimit, përmes një analize të të dhënave që pasqyrojnë këtë ndërlidhje mes përjetimit subjektiv dhe kushteve objektive. Për të kuptuar më saktësisht faktorët që ndikojnë në rritjen e prirjeve për emigrim të banorëve nga Shqipëria, të anketuarit u pyetën në lidhje me arsyet kryesore që i shtynjë drejt synimit për të emigruar. Të dhënat prej anketimit në lidhje me këtë paraqiten në figurën 14.

Figura 14: Arsyet kryesore të emigrimit potencial të banorëve



Ashtu si tregohet edhe prej rezultateve të anketimit faktorët ekonomikë, niveli i pagave, mundësitë e punësimit, cilësia e shërbimeve publike në vend janë ndër arsyet kryesore që i shtynjë banorët të mendojnë dhe planifikojnë largimin nga vendi. Për 37.4 % të të anketuarve aryeja për migrimin potencial lidhet me mundësitë më të mira për punësim jashtë vendit (faktor tërheqës); 25.3% e tyre e

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

përcaktojnë si faktor kryesor kushtet ekonomike dhe nivelin e pagave, rezultat i cili tregon se mungesa e sigurisë ekonomike në vend është një shtysë e fuqishme drejt migrimit, veçanërisht për të rinjtë; 16.2% e migrantëve potencial e lidhin planin për të emigruar me arsimimin dhe kualifikimin jashtë vendit. Të dhënat tregojnë se emigrimi shihet edhe si një rrugë për përmirësim akademik dhe profesional, jo thjesht ekonomik. Kjo sugjeron se për një pjesë të popullsisë, emigrimi përfaqëson një investim afatgjatë në zhvillimin personal. Rezultatet e anketimit treguan gjithashtu se 9.1 % planifikojnë të emigrojnë për shkak të ribashkimit më familjarët e tyre jashtë vendit, tregues i cili pasqyron ndikimin e lidhjeve sociale dhe familjare si një faktor i rëndësishëm në vendimmarrjen për të emigruar; 5.1 % nuk kanë dëshirë të jetojnë në Shqipëri dhe 4.4% e të anketuarve që planifikojnë të emigrojnë e lidhin planin e tyre migrator me mungesën e perspektivës për të ardhmen në vend. Edhe pse këto janë arsyse më pak të përmendura gjithsesi reflektojnë pakënaqësi të thella personale ndaj realitetit të brendshëm. Të dhënat prej studimit konfirmojnë gjetjet e studimeve të tjera rreth migrimit shqiptar mbi ndikimin që kanë faktorët ekonomik, social dhe rolin e rrjeteve familjare e sociale në vendimmarrjen për të emigruar. Gjetjet theksojnë se motivet ekonomike dhe punësimi janë shtyllat kryesore të emigrimit potencial nga Shqipëria, të pasuara nga aspiratat për përmirësim arsimor dhe faktorët familjarë.

Këto argumente përforcohen edhe prej treguesve statistikorë në figurën 15. Të anketuarit u pyetën se çfarë do ndikonte që ata të ndyshonin mendimin apo planin për t'u larguar nga vendi. Përgjigjet e të anketuarve përforcojnë treguesit mbi motivet që nxitin flukset në rritje të migrantëve potencial, të lidhura kryesisht me standartin e jetesës, punësimin dhe të ardhurat. 38.4% e të anketuarve theksuan se do të hiqnin dorë nga plani migrator nëse do të kishin një statndart më të lartë jetese në vend. Kjo tregon se shumica e njerëzve nuk janë të kënaqur me cilësinë e përgjithshme të jetesës në vend. 24.7% e tyre do të ndryshonin mendim nëse do të kishin të ardhura më ta larta dhe 15.1% nëse do të siguronin një punë të përshtatshme në vend. Krahas faktorëve ekonomikë, mirëqenia sociale dhe cilësia e shërbimeve (17.8%) mbeten motive që nxitin dëshirën për migrim.

Figura 15: Grafiku i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen “Çfarë do të bënte të ndryshonit mendim për të mos u larguar nga vendi?”




Grafiku tregon se emigrimi potencial nuk është vetëm rezultat i një faktori, por i një kombinimi faktorësh ekonomikë dhe cilësorë të jetesës. Për të frenuar këtë prirje, politikatat publike duhet të përqendrohen në rritjen e standardit të jetesës, përmirësimin e të ardhurave, forcimin e politikave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve duke ofruar më tepër siguri për banorët.

Destinacionet kryesore për emigrantët potencial

Ndër destinacionet kryesore të migrantëve potencial, sipas të dhënave prej anketimit janë Gjermania (28.3%), SH. B. A (23.2%), Italia (9.6%), Greqia (8.9%), Anglia (7.8%), Kanadaja (5.1%), Franca (3.8%), vendet nordike (Suedi/Norvegji/Finlandë 3.4%), Spanjë (1.7%) dhe 8.2% e të anketuarve kanë pëzgjedhur si destinacion vende të tjera (si Belgjikë, Hollandë, Rumani etj). Të dhënat e pasqyruara në figurën 15 ndihmojnë në kuptimin e prirjeve të orientimit migrator.

Gjermania dhe Sh. B. A mbeten vendet më të preferuara për migrantët potencialë nga Shqipëria përgjithësisht, po ashtu edhe për migrantët e mundshëm nga rajoni i Korçës. Gjermania shihet si destinacioni më tërheqës për migrantët potencial (28.3%).

Figura 16: Destinacionet kryesore të emigrantëve potencial



Gjermania perceptohet si një vend social, me mundësi të larta për punësim, politika të favorshme për punëtorë të kualifikuar dhe sistemit të qëndrueshëm social (QSES 2018: 52). Gjithashtu Kjo përputhet me zhvillimet e viteve të fundit, ku Gjermania ka ofruar mundësi të zgjeruara për punësim, sidomos në sektorët e teknologjisë, shëndetësisë dhe ndërtimit, si dhe ka lehtësuar procedurat për punëtorët e kualifikuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Destinacioni i dytë më i preferuar për migrantët potencialë nga rajoni i Korçës janë SH. B. A (23.2%), të cilat tradicionalisht përbëjnë një destinacion tërheqës për shkak të perceptimit të tyre si vend i mundësive të pakufizuara, zhvillimit profesional dhe cilësisë së jetesës. Megjithëse më larg gjeografikisht, SH.B.A mbeten në fokusin e atyre që kërkojnë një emigrim më afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

Italia dhe Greqia, dy destinacionet tradicionale të migrantëve shqiptarë, mbeten të rëndësishme për shkak të afërsisë gjeografike, lidhjeve historike dhe pranisë së komuniteteve të mëdha shqiptare në këto vende. Megjithatë ka një rënie të dukshme të emigrantëve shqiptarë në këto dy destinacione, krahasuar me dy dekadat e para të migrimit modern shqiptar. Papunësia e lartë dhe e zgjatur që përjetuan këto dy vende, si pasojë e krizës ekonomike globale ndikoi në rënien e ndjeshme të interesit dhe tërheqjes për to nga migrantët shqiptarë. Gjetjet prej anketimit tregojnë se destinacione të tjera të përmendura përfshijnë Kanadanë

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

(5.1%), vendet nordike si Suedia, Norvegjia dhe Finlanda (3.4%), Francën (3.8%) dhe Spanjën (1.7%), të cilat përfaqësojnë alternativa të dëshirueshme për migrantët potencial.

Të dhënat prej anketimit konfirmojnë gjithashtu edhe gjetjet e studimeve të tjera në lidhje me një riorientim të flukseve të migrantëve drejt vendeve të zhvilluara BE (Gjermani, Angli, Suedi, Norvegji), SH.B. A dhe Kanadasë. Prirjet e paraqitura në grafik tregojnë një orientim të qartë drejt vendeve me ekonomi të fortë dhe politika të hapura për pranimin e migrantëve, veçanërisht për punëtorë të kualifikuar. Përzgjedhja e destinacioneve ndikohet jo vetëm nga faktorë ekonomikë dhe institucionalë, por edhe nga prania e diasporës shqiptare dhe përvoja historike e migrimit.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu në lidhje me arsyet e përzgjedhjes së vendit të dëshiruar për të emigruar. Përgjigjet e tyre në lidhje me arsyet e përzgjedhjes së vendit të destinacionit paraqiten në figurën 17.

Figura 17: Arsyet e përzgjedhjes së vendit të destinacionit për migrantët potencial



Grafiku paraqet arsyet kryesore që të anketuarit përmendin si faktorë vendimtarë në zgjedhjen e vendit të destinacionit për emigrim. Të dhënat janë të shprehura në përqindje dhe japin një pasqyrë të prioriteteve të migrantëve potencial. Të dhënat prej anketimit tregojnë qartë se arsyet ekonomike dhe sociale dominojnë vendimmarrjen për zgjedhjen e vendit të emigrimit:

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

- Mundësitë për punësim (30.3%) janë faktori më i rëndësishëm në zgjedhjen e vendit të destinacionit. Kjo tregon se për pjesën më të madhe të të anketuarve, emigrimi lidhet drejtpërdrejt me përpjekjen për të siguruar punë më të mirë dhe më të qëndrueshme sesa ajo që ofrohet në vendin e origjinës.
- Standardi i lartë i jetesës dhe mirëqenies sociale (25.5%) është faktori i dytë më i përmendur, duke reflektuar dëshirën për të jetuar në vende që ofrojnë siguri sociale, përkujdesje shëndetësore cilësore dhe kushte të përmirësuara jetese.
- Rrjetet sociale ekzistuese përfaqësojnë një tjetër faktor të rëndësishëm: 17.3% e të anketuarve thonë se kanë familjarë, të afërm apo miq në vendin ku planifikojnë të emigrojnë. Kjo tregon ndikimin e lidhjeve sociale në procesin e migrimit, duke ofruar mbështetje fillestare dhe lehtësim në përshtatje.
- Të ardhurat më të larta që ofrojnë vendet e destinacionit (11.6%) dhe sistemi më i mirë arsimor/shëndetësor (11.2%) përforcojnë faktin se vendet e destinacionit perceptohen si alternativa më të mira për zhvillim individual dhe familjar.
- Arsytet më pak të përmendura përfshijnë njohjen e gjuhës së vendit (1.7%); përvoja e mëparshme e emigrimit në atë vend (1.4%) dhe lehtësia e procesit të emigrimit (1.0%). Këto përqindje të ulëta tregojnë se faktorët administrativë dhe kulturorë, ndonëse ndihmojnë në zgjedhjen e vendit, nuk janë përcaktuesit kryesorë në vendimmarrje.

Zgjedhja e vendit të destinacionit nga migrantët potencialë është e lidhur ngushtë me faktorë ekonomikë dhe socialë, veçanërisht mundësitë për punësim dhe standartin e jetesës. Rrjetet sociale ekzistuese në vendet pritëse gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm. Prania e rrjeteve sociale transnacionale ka një marrëdhënie pozitive të konsiderueshme me synimin për të migruar. Dëshira e njerëzve për të migruar është shuma e faktorëve që ata i perceptojnë si të pakëndshëm në vendin e tyre të origjinës, të njohur si faktorë shtytës, si edhe lidhjeve sociale në vendet e mundshme të destinacionit që u ofrojnë atyre mundësi të perceptuara.

Studimet tregojnë se të anketuarit që kanë të afërm ose miq që jetojnë në një vend të huaj kanë më shumë gjasa të thonë se do të donin të zhvendoseshin përgjithmonë në një vend tjetër nëse do të kishin mundësi. Edhe ata me familje ose miq që janë kthyer nga jashtë vendit kanë më shumë gjasa të dëshirojnë të zhvendosen. Përvoja si e kaluar ashtu edhe e tanishme me anëtarët e familjes ose të tjerë që kanë shkuar jashtë vendit është një burim besimi për migrantët potencial. Këtë argument e mbështetin edhe rezultatet e studimit tone, të cilat

tregojnë se 20.5 % e të anketuarve shprehen se të afërmit e tyre apo familjarët në emigracion janë duke i ndihmuar për të realizuar projektin e tyre migrator. Prania e rrjeteve sociale jashtë vendit zë përqindjen më të madhe në mesin e të gjithë faktorëve që ndihmojnë apo lehtësojnë përmbushjen e synimeve për të emigruar te banorët e përfshirë në studim. Rrjetet familjare dhe sociale jashtë vendit ndikojnë jo vetëm në vendimin për migrim, duke krijuar ndjesinë e mbështetjes dhe orientimit në vendin pritës, por njëkohësisht përcaktojnë edhe zgjedhjen e destinacionit të migrantëve potencial. Hulumtimet mbi ndryshimin e mënyrës së jetesës si rezultat i zhvendosjes së njerëzve në kërkim të një mënyre më të mirë jetese tregojnë se migrantët shpjegojnë zgjedhjen e tyre specifike të destinacionit duke marrë parasysh faktorë të tillë si kostoja relative e jetesës, ritmi i jetës dhe ndjenja e komunitetit (Benson dhe O'Reilly 2009).

Duke u mbështetur në këta tregues statistikorë ne synojmë të interpretojmë rritjen e tendencës për migrim të shqiptarëve nën këndvështrimin e qasjes teorike të shkakësisë grumbulluese (Massey et al, 1993; Fussel & Massey 2004) . Analiza jonë mbi migrimin potencial dhe rrjetet sociale të migrantëve bazohet në tezën se individët me rrjete sociale të lidhura ngushtë me komunitetet e destinacionit kanë më shumë gjasa të migrojnë. “Mirëqenia subjektive” (Lovo 2014) shndërrrohet në faktor përcaktues të planit migrator dhe njëkohësisht të vlerësimit të suksesit të një vendi. Mirëqenia subjektive përfaqëson perceptimin që individët kanë për nivelin e mirëqenies dhe kënaqësisë në një vend të caktuar apo mundësive për punësim, në sajë të përvojës së emigrantëve aktualë (familjarë, të afërm apo miq të tyre në emigracion). Njerëzit formojnë opinionet e tyre për nivelin e mirëqenies dhe mundësive në vendet e tjera, jo në sajë të treguesve standarde makroekonomike (PBB për frymë, normat e papunësisë apo taksa mbi të ardhurat etj), por nëpërmjet kontakteve dhe rrjeteve informale sociale.

Ndikim pozitiv në dëshirën dhe gatishmërinë për të lëvizur luajnë migrantët e hershëm. Sigurisht që individët të cilët planifikojnë të migrojnë kanë nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e miqve/ të afërmeve kur lëvizin dhe vendosen në një vend të ri. Kështu migrantët potencialë modelojnë vendimin për të migruar si funksion i informimit, mbështetjes, apo shërbimeve që marrin nga migrantë e hershëm, të cilët janë pjesë e rrjetit të tyre social apo familjar. Bazuar në këtë këndvështrim, mund të supozojmë se individët kanë më shumë gjasa të migrojnë në destinacionet ku ata kanë një numër më të madh kontaktesh apo rrjetesh sociale. Ky supozim mbështetet edhe prej rezultateve të anketimit të cilat tregojnë se 17.3% e migrantëve potencial e lidhin destinacionin e zgjedhur me rrjete sociale familjare, miqësore. Prania e rrjeteve sociale jashtë vendit është faktori i tretë (pas mundësive për punësim dhe standartit të jetesës) që ndikon në


përzgjedhjen e destinacionit të migrantëve potencial. Ekzistenca e rrjeteve sociale luan një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e vendit të migrimit. Të afërmit apo miqtë të cilët kanë një përvojë emigrimi në një vend të caktuar e rrit tërheqjen e migrantëve potencialë ndaj këtij vendi. Pra sa e madhe qasja në rrjetet sociale të migrantëve aq më e madhe prirja për të migruar në mesin e popullatës jo migrante. Këto gjetje janë të rëndësishme për të kuptuar motivet prapa lëvizjeve migratore.

Shkalla e informimit të migrantëve potencial rreth destinacionit të përzgjedhur

Krahas identifikimit të destinacioneve kryesore të migrantëve potencial dhe arsyeve për përzgjedhjen e tyre, të anketuarit u pyetën lidhur me shkallën e informimit që kanë ata mbi mënyrën e jetesës dhe qëndrimin në vendet që planifikojnë të emigrojnë. Niveli i informimit të migrantëve potencial për destinacionin e përzgjedhur është një komponent kyç për të kuptuar gatishmërinë, qëndrueshmërinë dhe fazën e zhvillimit të planit migrator. Referuar të dhënave në lidhje me këtë tregues (figura 18) vihet në dukje një % shumë e lartë e të anketuarve që janë të mirëinformuar për destinacionin e zgjedhur: 48.5% e tyre janë mjaftueshëm të informuar dhe 25.3% janë shumë të informuar. Kjo tregon se migrimi për shumicën e të anketuarve është një synim i qartë, rezultat i kërkimeve, konsultimeve dhe ndoshta përvojës së rrjeteve të njohura në vendin pritës. Migrantët të cilët janë shumë ose mjaftueshëm të informuar ka më shumë gjasa të kenë ndërmarrë veprime konkrete si aplikim për punë, studime, mësimi i gjuhës së vendit pritës, sigurimi i dokumenteve, mbështetje nga rrjetet sociale etj.

Informimi i thelluar shërben si tregues i fazës së avancuar të planit migrator dhe është shpesh parakusht për vendimmarrje të suksesshme dhe të qëndrueshme. Një rezultat i tillë rreth shkallës së informimit për vendin pritës përforcon gjetjet e mësipërme se migrantët potencial janë duke bërë përgatitje aktive për largim, duke analizuar mundësitë reale dhe sfidat që mund t'i presin në vendin pritës. Në këtë kuptim, informimi nuk është pasiv, por pjesë përbërëse e vendimmarrjes strategjike për të migruar.

Figura 18: Shkalla e informimit të migrantëve potencialë për vendin pritës



Një rol të rëndësishëm në informimin e migrantëve potencial për vendin pritës luajnë edhe rrjetet sociale të migrantëve. Rrjetet sociale marrin rëndësi të madhe pasi ulin koston materiale dhe psikologjike të migrimit, duke u siguruar migrantëve potencial informacionin dhe mbështetjen që u duhet në fillim të përvojës emigratore. Pra kapitali njerëzor dhe transferueshmëria e tij janë faktorë kryesorë shpjegues për zgjedhjen e një destinacioni të caktuar. Të dhënat prej anketimit treguan se të anketuarit që kanë të afërm, familjarë në emigrim janë tepër të informuar rreth mënyrës së jetesës dhe qëndrimit në destinacionin e përzgjedhur për të emigruar. Koncretisht 32.8% e të anketuarve që kanë miq/familjarë të cilët po i ndihmojnë të realizojnë planin për migrim janë shumë të informuar rreth mënyrës së jetesës në vendin që planifikojnë të emigrojnë; 50.8% e tyre janë mjaftueshëm të informuar; 13.1% e tyre kanë zgjedhur alternativën 'neutral' dhe vetëm 3.3% janë pak të informuar.


2.3 Vendimmarrja për të emigruar

Në kontekstin shqiptar, migrimi është shpesh një proces kompleks që përfshin jo vetëm individin, por edhe strukturën familjare në tërësi. Duke qenë një fenomen me ndikim të gjerë social dhe ekonomik, vendimmarrja për të emigruar nuk merret lehtësisht dhe shpesh përfshin diskutime, konsultime dhe bashkërendime brenda familjes. Të dhënat prej anketimit në lidhje me vendimmarrjen për të emigruar të paraqitura në figurën 19 tregojnë qartë se për shumicën e migrantëve

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

potencial, migrimi përjetohet si një vendim kolektiv, ku përfshihen të gjithë anëtarët e familjes (56.8%). Ndërsa 37.8% e të anketuarve që planifikojnë të largohen e kanë marrë vendimin individualisht, duke reflektuar një tendencë drejt autonomisë personale në planifikimin e migrimit. Kjo mund të jetë më e zakonshme tek të rinjtë, të cilët shpesh ndjekin mundësi studimi apo punësimi jashtë vendit pa përfshirë të gjithë familjen. Këto modele të vendimmarrjes pasqyrojnë jo vetëm strukturën e familjes shqiptare, por edhe ndryshimet që po ndodhin në raportin midis individit dhe grupit në kontekstin e migrimit.

Figura 19: Vendimmarrja për të emigruar



Edhe kur vendimi për të emigruar merret individualisht apo nga pjesa tjetër e familjes (nëna, babai, burri, gruaja) përsëri konstatohet një shkallë e lartë e mbështetjes nga pjesa tjetër e familjes. Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘vendimmarrja për të emigruar’ dhe ‘mbështetja nga familjarët e vendimmarrjes për migrim’ (tabela 9) tregon se 92.8% e të anketuarve që e kanë marrë tërësisht vetë vendimin për të emigruar dhe 81.2% e atyre që pohojnë se vendimi për të emigruar e ka marrë pala tjetër, kanë gjetur mbështetjen e familjes për këtë vendim.

Mbështetja familjare në kontekstin shqiptar mbetet një faktor i rëndësishëm për realizimin e sukseshëm të projektit migrator. Emigrimi shpesh ndikon jo vetëm individin që largohet, por edhe ata që mbeten pas, prandaj vendimi shihet si një “projekt familjar”. Mbështetja e familjes krijon ndjesinë e legjitimitetit moral dhe social për të ndërmarrë hapin e emigrimit. Gjithashtu familjarët janë të përfshirë në përgatitjen për emigrim: sigurimin e dokumenteve, financimin e udhëtimit,

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

kujdesin për fëmijët ose pronën, etj. Pa këtë mbështetje praktike, realizimi i planit për të emigruar bëhet më i vështirë. Nga ana tjetër mbështetja e familjes ofron një ndjenjë sigurie; pa këtë mbështetje, emigrimi mund të jetë më i vështirë, më i pasigurt dhe më i ngarkuar emocionalisht.

Tabela 9: Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘vendimmarrja për të emigruar’ dhe ‘mbështetja nga familjarët e vendimit për migrim’

		Kush e mori vendimin për të emigruar?			Total
		Tërësisht vetë	Tërësisht pala tjetër (burri/gruaja/nëna/babai)	Të gjithë bashkë	
A e mbështesin familjarët tuaj zgjedhjen për të emigruar?	Po	92.8%	81.2%	94.6%	93.2%
	Jo	7.2%	18.8%	5.4%	6.8%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

2.5. Migrim individual apo migrim familjar?

Në lidhje me planet për migrim familjar apo migrim individual (tabela 10) të dhënat nga anketa tregojnë një ndarje të qartë midis atyre që parashikojnë një migrim individual dhe atyre që synojnë një migrim familjar apo në çift. Konkretisht, 43.4% e të anketuarve që planifikojnë të emigrojnë synojnë ta bëjnë këtë vetëm, ndërsa 37.6% deklarojnë se do të largohen me familjen dhe 19.0% së bashku me partnerin/partneren.

Tabela 10: Plani për migrim individual apo migrim familjar (%)

Nëse keni plan të emigroni më kë do të largoheni?	Përqindje (%)
Vetëm	43.4
Me partnerin/en	19.0
Me familjen	37.6
Total	100.0

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Këto të dhëna sugjerojnë se migrimi potencial në Shqipëri përjetohet në mënyra të ndryshme, që lidhen ngushtë me karakteristikat personale, fazat e jetës dhe strategjitë sociale dhe ekonomike të individëve. Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘migrim familjar apo migrim individual’ dhe ‘grupmosha’ tregojnë se emigrimi individual është forma më e përhapur kryesisht në mesin e të anketuarve të grupmoshës së re (tabela 11).

Kështu 60% e migrantëve potencial që planifikojnë të emigrojnë vetëm i përkasin grupmoshës 18-24 vjeç dhe 49.1% e tyre i përkasin grupmoshës 25-34 vjeç. Ndërsa migrimi familjar zë një % të lartë kryesisht në mesin e të anketuarve të grupmoshës 35-44 vjeç (69.6%) dhe grupmoshës 45- 54 vjeç (58.8%). Referur studimeve rreth migrimit shqiptar konstatohet se përgjithësisht në dekadën e parë të emigrimit modern shqiptar mbizotëronte migrimi individual (Caro 2011; King 2004). Veçanërisht gjatë viteve 1990–2000, emigrimi ishte kryesisht individual dhe i motivuar ekonomikisht, me synimin për të siguruar të ardhura dhe për të mbështetur ekonomikisht familjet që mbeteshin në vend. Kjo strategji u shoqërua me dërgimin e remitancave dhe shpesh me qëndrime të përkohshme, por të zgjatura.

Modeli i migrimit shqiptar, sidomos pas viteve 2000, është shndërruar nga një migrim kryesisht individual i përkohshëm në një migrim më të organizuar familjar, në përputhje me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe krijimin e rrjeteve të qëndrueshme migratore jashtë vendit (Gësheshi & King 2018; IOM 2021; Instat 2020). Migrimi familjar shqiptar është rritur ndjeshëm sidomos në dekadën e fundit, duke u ndikuar nga zhvillimet socio-ekonomike në vend, papunësia afatgjatë dhe mungesa e perspektivës për mirëqenie të qëndrueshme. Emigracioni shqiptar ka kaluar në një fazë ku edhe vendimi për migrim merret gjithnjë e më shumë në kuadrin e familjes¹⁸, duke reflektuar nevojën për stabilitet afatgjatë, arsim më të mirë për fëmijët dhe siguri socio-ekonomike. Një tipar dallues i migrimit familjar shqiptar është se ai shpesh ndodh në dy faza: fillimisht largohet një anëtar i familjes dhe më pas realizohet bashkimi familjar përmes procedurave ligjore, pasi janë siguruar strehimi dhe punësimi.

¹⁸ Ky konstatim mbështetet edhe prej të dhënave të anketimit tonë të paraqitura në figurën 18.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 11: Të dhënat e krostabuluara për variablat ‘plani për migrim familjar/individual’ dhe ‘grupmosha’


	Nëse planifikoni të emigroni me kë do largoheni?			Total
	Vetëm	Me partnein/en	Me familjen	
18-24 vjec	60.0%	17.9%	22.1%	100.0%
25-34 vjec	49.1%	19.3%	31.6%	100.0%
Grupmosha 35-44 vjec	21.4%	8.9%	69.6%	100.0%
45-54 vjec	8.8%	32.4%	58.8%	100.0%
Mbi 55 vjec	12.5%	50.0%	37.5%	100.0%
Total	43.4%	19.0%	37.6%	100.0%

2.6. Planet për kohën e qëndrimit në vendin pritës

Një tregues i rëndësishëm për analizat rreth ndikimit të migrimit potencial për shoqëritë dërguese është edhe kohëzgjatja e planit migrator. Dimensioni kohor i projektit migrator merr rëndësi për vendin e origjinës, pasi në sajë të këtij treguesi mund të vlerësohet potenciali për kthimin e migrantëve, rrjedhën e remitançave, dhe pasojat demografike dhe sociale, siç janë plakja e popullsisë, mungesa e fuqisë punëtore apo zbrazja e zonave rurale. Rezultatet e anketës në lidhje me këtë tregues paraqiten në figurën 20.

Të dhënat mbi kohëzgjatjen e planit migrator tregojnë se 33% e të anketuarve shprehen se planifikojnë të largohen përfundimisht nga Shqipëria. Kjo shpërndarje sugjeron se emigracioni është perceptuar jo thjesht si një lëvizje e përkohshme për të përballuar vështirësi, por si një strategji afatgjatë ose përfundimtare për të ndërtuar një jetë të re. Ndërsa një përqindje po aq e lartë (33.7%) deklaroi se nuk e di sa kohë do të qëndrojë në vendin pritës. Një tregues i tillë mund të lidhet shpesh me pasiguritë që shoqërojnë jetën në vendin pritës. Kjo pasiguri shtohet edhe nga mungesa e një kulture të planifikimit afatgjatë, sidomos ndër të rinjtë. Për ta largimi mund të jetë një reagim ndaj situatës në vend, më shumë se sa një strategji e menduar mirë për të ardhmen ose mund të pasqyrojë natyrën e hapur dhe të kushtëzuar të projekteve migratore, të cilat shpesh formësohen dhe konkretizohen vetëm pasi individit vendoset jashtë vendit dhe fillon të ndërtojë përvojën e tij migratore.

Figura 20: Kohëzgjatja e planit migrator



Individët që janë duke u përgatitur për të emigruar shpeshherë nuk kanë një ide të qartë për kohëzgjatjen, jo për shkak të mungesës së qëllimit apo vendosmërisë, por për shkak të faktorëve të shumtë të paparashikueshëm që ndikojnë ecurinë e jetës jashtë vendit, që nga mundësia për integrim, deri tek rrjedhat personale dhe familjare. Ndërkohë, 24.8% e të anketuarve synojnë një qëndrim afatgjatë (mbi pesë vjet), që mund të interpretohet si një migrim ekonomik me objektiv të strukturuar, por pa ndërprerë përfundimisht lidhjen me vendin e originës. Në kontrast, vetëm 8.5% e të anketuarve planifikojnë të qëndrojnë jashtë vendit për një periudhë të caktuar (1–5 vjet)¹⁹. Rezultatet e mësipërm tregojnë se migrimi nuk konsiderohet më si një zgjidhje e përkohshme për përmirësim ekonomik, por si një projekt jetësor që lidhet ngushtë me synimin për integrim të qëndrueshëm jashtë vendit.

¹⁹ Periudha 1deri 5 vite qëndrimi në vendin pritës është identifikuar nga studiuesit si një alternativë përgjigjeje për të anketuarit duke pasur në konsideratë largimet për qëllime studimi dhe specializimi të cilat kanë një kohëzgjatje të caktuar. Në këtë kontekst kjo periudhë kohore e lidhur edhe me qëllimin e migrimit është interpretuar si kohë qëndrimi e përcaktuar (e përkohëshme), që mund të shoqërohet ose nga kthimi i migrantit pas përfundimit të planeve migratore ose mund të pasohet nga qëndrimi afatgjatë (mbi 5 vite). Një kategorizim i tillë i variablit “kohëzgjatja e planit migrator” vjen në përputhje me qëllimin dhe kontekstin e studimit dhe nuk reflekton përkufizimin shkencor të termit ‘migrim afatshkurtër’ dhe ‘migrim afatgjatë’.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 12: Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘kohëzgjatje e planit migrator’ dhe ‘arsyet për emigrimin’

		Sa kohë mendoni të jetoni jashtë vendit?				Total
		Përkoheisht (1-5 vjet)	Afatgjatë (5+ vjet)	Përgjithmonë	Nuk e di	
Cilat janë arsyet pse doni të emigroni?	Mundësi më të mira punësimi jashtë vendit	28.0%	46.6%	37.1%	34.3%	37.8%
	Arsimi/specializimi jashtë vendit	44.0%	11.0%	7.2%	20.2%	15.6%
	Kushtet ekonomike dhe niveli i pagave	16.0%	26.0%	28.9%	19.2%	23.8%
	Sistemi shëndetësor me i mire		1.4%	5.2%	1.0%	2.4%
	Situata politike dhe sociale			2.1%	3.0%	1.7%
	Ribashkimi me familjarët jashtë vendit	4.0%	12.3%	11.3%	6.1%	9.2%
	Nuk më pëlqen të jetoj në Shqipëri	4.0%		5.2%	9.1%	5.1%
	Nuk ka prespektive për të ardhmen në vend	4.0%	2.7%	3.1%	6.1%	4.1%
	Tjetër				1.0%	0.3%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	

Planifikimi i kohëzgjatjes së qëndrimit jashtë vendit ndikohet nga një sërë faktorësh si qëllimi i emigrimit, mundësitë për integrim në vendin pritës, situata ekonomike dhe sociale në vendin e origjinës, burimet dhe rrjetet mbështetëse etj. Për t’i dhënë kuptim gjetjeve rreth kohëzgjatjes së planit migrator të migrantëve potencialë i jemi referuar lidhjes ndërmjet arsyeve që i çojnë të anketuarit drejt emigrimit dhe planit për kohëqëndrimin në vendin pritës.

Të dhënat e krostabuluara për këto dy variabla (tabela 12) tregojnë se synimi për të emigruar përgjithmonë lidhet ngushtësisht me faktorë ekonomikë dhe socialë, të tillë si kushtet ekonomike, niveli i pagave, mundësitë e punësimit jashtë vendit, ribashkimi me familjarët etj. Në këtë grup, përqindja e atyre që kërkojnë punësim jashtë vendit është e lartë (37.1%). Ndërkaq, ata që planifikojnë një qëndrim me kohëzgjatje të përcaktuar (1–5 vjet) tregojnë më shumë interes për arsimin dhe specializimin jashtë vendit (44%), çka nënkupton një projekt më të strukturuar dhe me kthim të mundshëm në vend. Grupet që synojnë qëndrim afatgjatë (5+ vjet), por jo domosdoshmërisht të përhershëm, përfaqësojnë një ndërthurje të arsyeve ekonomike dhe sociale, me një theks të veçantë në gjetjen e punës dhe kushteve më të mira jetese, por edhe në ribashkimin familjar.

Përqindjen më të madhe në mesin e të anketuarve që planifikojnë qëndrim afatgjatë e zënë migrantët potencial që synojnë të largohen për shkak të mundësive më të mira për punësim jashtë vendit (46.6%); kushteve ekonomike në vend (26%), si edhe për shkak të ribashkimit me pjesën tjetër të familjes (12.3%).

Plani për kthim në vendlindje

Në vijim të analizës për kohëzgjatjen e projektit migrator i referohemi një treguesi tjetër të rëndësishëm që lidhet me mundësinë për kthim në vendin e origjinës të migrantëve potencial. Procesi i kthimit të emigrantëve përbën një faktor kyç për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, pasi migrantët e kthyer sjellin me vete kapitale të ndryshme: financiare (kursime), humane (aftësi, përvoja profesionale, ide dhe mentalitete të reja) dhe sociale. Megjithatë, ndikimi i këtij rikthimi varet nga disa faktorë, që lidhen së pari me kohëzgjatjen e qëndrimit në vendin pritës, qëllimin e projektit migrator dhe mundësitë apo kushtet që ofron vendi i origjinës për tërheqjen e migrantëve. Nga njëra anë, rëndësi ka koha që kalojnë jashtë vendit dhe arsytet që i shtynë të kthehen. Përfitimet për vendin e origjinës janë më të mëdha kur emigrantët kthehen pas një periudhe të mjaftueshme që u ka mundësuar të realizojnë objektiva si kursimi, arsimimi apo formimi profesional, veçanërisht kur janë të rinj dhe të gatshëm të investojnë dijet dhe kursimet e tyre në Shqipëri. Nga ana tjetër, rëndësi thelbësore ka edhe dinamika e zhvillimit të vendit të origjinës, për të ofruar kushte të përshtatshme që mundësojnë shfrytëzimin efikas të këtyre kapitaleve dhe tërheqjen e migrantëve. Kështu të anketuarit të cilët planifikojnë dhe përgatiten për të emigruar u pyetën rreth planeve të tyre për rikthim në vendlindje. Rezultatet prej përgjigjeve të tyre të paraqitur në figurën 21 tregojnë se pjesa më madhe e migrantëve potencial 40.1%, shprehen se nuk janë të sigurt nëse do të kthehen apo jo, duke reflektuar një qëndrim të lëkundur dhe të varur nga përvojat që do të kenë jashtë vendit. Ndërkohë, 26.9% nuk e kanë në plan kthimin, çka tregon për një prirje drejt vendosjes afatgjatë ose të përhershme jashtë. Një pjesë më e vogël, 20.4%, e lidh vendimin për t'u kthyer me përmirësimin e kushteve në Shqipëri, gjë e cila tregon se kthimi është një opsion i kushtëzuar. Vetëm 12.6% deklarojnë qartë se planifikojnë të kthehen gjithsesi.


Këto të dhëna pasqyrojnë qartë mungesën e një strategjie të kthimit në pjesën më të madhe të projekteve migratore dhe e vendosin fokusin te faktorët që ndikojnë në vendimarrjen për të qëndruar ose jo përgjithmonë jashtë vendit. Edhe pse kthimi në vendlindje i migrantëve potencial varet nga një sërë faktorësh që lidhen me përvojën konkrete emigratore në vendin pritës, përsëri këta tregues japin një pasqyrë të përgjithshme mbi mundësinë e kthimit të tyre dhe faktorët që mund ta

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

favorizojnë ose pengojnë këtë proces. Kur një përqindje e lartë e të anketuarve shprehen se nuk janë të sigurt ose nuk planifikojnë të kthehen, kjo sugjeron një mungesë besimi në përmirësimin e kushteve në vendin e origjinës. Kjo pasiguri është thelbësore për hartimin e politikave të synuara, sepse tregon nevojën për ndërhyrje në fusha kyçe si ekonomia, punësimi, shëndetësia dhe qeverisja.

Ndërkohë, fakti që një pjesë e të anketuarve do të kthehen nëse përmirësohen kushtet është një mundësi e rëndësishme: nënkupton se me politikat e duhura, kthimi mund të stimulohet. Këta tregues mund të ndihmojnë politikbërësit të kuptojnë sa shpresë ka për rikthim dhe çfarë duhet të ndryshojë që ai të ndodhë.

Figura 21: Planet për kthim në vendlindje të migrantëve potencial



Duke krahasuar të dhënat rreth kohëzgjatjes së planit migrator dhe planit për kthim në vendlindje të paraqitura në figurën 20 dhe 21 vihet në dukje një përputhje e qartë e këtyre treguesve, çka tregon se këto rezultate mbështesin njëra-tjetrën. Në figurën 20 vihet re se një përqindje e lartë e individëve (33.7%) nuk e dinë se për sa kohë planifikojnë të qëndrojnë jashtë vendit, ndërsa një tjetër pjesë e konsiderueshme (33.0%) shprehen se kanë në plan të emigrojnë përgjithmonë. Këto të dhëna korrespondojnë me të treguesit në e figurën 21, ku 40.1% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë të sigurt nëse do të kthehen, ndërsa 26.9% shprehen se nuk e kanë në plan kthimin. Pra, pasiguria në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit jashtë vendit shoqërohet me pasiguri ose mungesë të një plani konkret për kthim. Në mënyrë të ngjashme, pjesa që shprehet se planifikon të largohet përgjithmonë përputhet me ata që deklarojnë se nuk mendojnë të

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

kthehen. Kjo përputhje tregon se për shumë individë, emigrimi nuk është një zgjidhje e përkohshme, por shpesh përjetohet si një ndryshim i përhershëm, gjë e cila ka rëndësi të madhe për analizat demografike dhe për planifikimin e politikave publike në vendin e origjinës.

2.7. Niveli i kënaqësisë/pakënaqësisë ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike

Bazuar në studimet rreth migracionit dhe arsyeve që lidhen me të, si edhe në rezultatet e mësipërme të anketimit rreth faktorëve që nxitin lëvizjet migratore konstatohet se ka një sërë faktorësh ‘tërheqës’ dhe faktorësh ‘shtytës’. Këta të fundit lidhen me kushte ose rrethana negative në vendin e origjinës që nxisin individët të largohen dhe të kërkojnë një jetë më të mirë diku tjetër. Këta faktorë krijojnë një ndjenjë pakënaqësie, pasigurie apo mungese perspektive dhe shpesh përbëjnë arsyet kryesore pse njerëzit vendosin të emigrojnë. Faktorët ekonomikë dhe diferenca e madhe në të ardhura me vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian dhe Amerikës së Veriut nuk janë arsyet e vetme që nxisin dëshirën për emigrim nga Shqipëria. Të dhënat e studimit tregojnë se të anketuarit në përgjithësi, dhe veçanërisht migrantët potencial, shprehin pakënaqësi të theksuar ndaj shërbimeve publike dhe funksionimit të disa nga institucioneve më të rëndësishme si sistemi arsimor, kujdesi shëndetësor, sistemi i sigurimeve shoqërore, tregu i punës, sistemi i drejtësisë etj. Në lidhje me këtë të anketuarit u pyetën në lidhje me nivelin e kënaqësisë/ pakënaqësisë ndaj shërbimeve publike dhe institucioneve në vend. Fillimisht u përllogarit koeficienti Alfa e Chronbach-ut, për të matur nivelin e besueshmërisë (konsistencën e brendshme të shkallëve). Kjo analizë realizohet për të parë nëse është i besueshëm matësi që kemi përdorur në hulumtim.

Analiza e Besueshmërisë

Alpha e Cronbach	Numri i njësive
.870	7

Bazuar tek koeficienti i besueshmërisë Cronbach Alpha e cila është 0.87 (87%) tregohet se shkallët kanë një qëndrueshmëri të brendshme të lartë. Pra matësi që kemi përdorur është mjaft i besueshëm në lidhje me nivelin e kënaqësisë nga institucionet dhe shërbimet publike në vend.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Item-Total Statistics				
	Scale Mean if Item Deleted	Scale Variance if Item Deleted	Corrected Item-Total Correlation	Cronbach's Alpha if Item Deleted
Sistemi arsimor (Shkollat, universitetet, trajnimet profesionale)	15.94	21.643	.671	.848
Sistemi shendetesor (spitalet, qendrat shendetesore, shërbimet mjekesore)	16.46	22.026	.624	.855
Tregu i punës (mundësitë për punësim dhe pagat)	16.64	21.785	.680	.847
Sistemi i sigurimeve shoqërore dhe pensionet	16.51	22.399	.657	.850
Shërbimet administrative dhe burokratike	16.24	22.159	.689	.846
Siguria publike dhe rendi	16.09	23.161	.572	.861
Sistemi i drejtësisë	16.36	22.402	.630	.854


Rezultatet e analizës së koeficientit Cronbach Alpha treguan se secila prej pyetjeve të përfshira në instrument është e domosdoshme për integritetin e shkallës së matjes. Konkretisht, vërehet se në çdo rast, heqja e një pyetjeje do të çonte në uljen e vlerës së alpha-s, çka nënkupton se të gjitha pyetjet kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në rritjen e konsistencës së brendshme. Ky rezultat përforcon bindjen se instrumenti është i strukturuar në mënyrë koherente dhe se asnjë prej pyetjeve nuk është e tepërt apo e panevojshme në matjen e konstruktit të “kënaqësisë.”

Të dhënat prej anketimit hedhin dritë mbi mënyrën se si migrantët potencial vlerësojnë cilësinë e shërbimeve publike në vend. Këto perceptime luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe vendimmarrjes për emigrim, pasi ato reflektojnë nivelin e kënaqësisë apo pakënaqësisë ndaj kushteve të jetesës në Shqipëri. Të dhënat e paraqitura në figurën 22 dhe tabelën 13 i takojnë vetëm të anketuarve të cilët janë duke u përgatitur dhe planifikojnë të migrojnë. Referuar treguesve vihet në dukje se në qendër të pakënaqësisë qëndron tregu i punës, i vlerësuar negativisht nga shumica dërrmuese e të anketuarve. Rreth 65% e tyre shprehen “aspak” ose “pak të kënaqur” me mundësitë për punësim dhe nivelin e pagave. Vetëm një përqindje shumë e vogël, rreth 10%, raportojnë njëfarë kënaqësie në këtë drejtim. Kjo pasqyron në mënyrë të qartë mungesën e perspektivës për punësim të qëndrueshëm dhe të shpërblyer në mënyrë të drejtë, duke e kthyer papunësinë dhe pasigurinë ekonomike në një ndër arsyt kryesore

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

shtytëse për emigrimin. Situatë e ngjashme vërehet edhe për sistemin shëndetësor, i cili perceptohet si jofunksional nga mbi gjysmën e të anketuarve (52%). Vetëm 14.9% e tyre janë të kënaqur me kujdesin shëndetësor që ofrohet. Kjo tregon mungesë besimi në institucionet shëndetësore publike, që përbën një indikator të rëndësishëm për cilësinë e jetës dhe sigurinë sociale. Sistemi i sigurimeve shoqërore dhe pensionet gjithashtu rezultojnë me vlerësime negative: 55.3% e të anketuarve janë aspak ose pak të kënaqur, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël (14.1%) shprehet pozitivisht. Ky tregues sugjeron mungesë sigurie për të ardhmen. Pakënaqësia është e ndjeshme edhe në lidhje me sistemin e drejtësisë, ku 47% e qytetarëve shprehen të pakënaqur, ndërsa vetëm 12.7% kanë një vlerësim pozitiv. Këto të dhëna flasin për një perceptim të theksuar të mungesës së drejtësisë, transparencës dhe efikasitetit në zgjidhjen e çështjeve ligjore. Ndërkohë, sistemi arsimor dhe shërbimet administrative shfaqin një ndarje më të balancuar të perceptimeve. Për arsimin, 34.3% janë të pakënaqur, ndërsa 26.9% shprehen të kënaqur; pjesa tjetër (38.8%) qëndron neutrale, çka mund të interpretohet si pasiguri apo pritshmëri të ulëta ndaj përmirësimit të sistemit. Shërbimet administrative kanë gjithashtu një përqindje të lartë vlerësimesh neutrale (45.5%), ndërsa 37.4% janë të pakënaqur dhe vetëm 17.1% të kënaqur.

Figura 22: Shkalla e kënaqësisë /pakënaqësisë së migrantëve potencial ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (%)



Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 13: Shkalla e kënaqësisë /pakënaqësisë së migrantëve potencial ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (%)

	Aspak i kënaqur	Pak i kënaqur	Neutral	I kënaqur	Shumë i kënaqur	Total
Sistemi arsimor	11.9	22.4	38.8	23.9	3.0	100
Sistemi shëndetsor	21.6	31.4	32.1	12.7	2.2	100
Tregu i punës (mundësitë për punësim dhe pagat)	23.9	41.0	25.4	8.2	1.5	100
Sistemi i sigurimeve shoqërore dhe pensionet	17.2	38.1	30.6	12.7	1.4	100
Shërbimet administrative	12.8	24.6	45.5	14.9	2.2	100
Siguria publike dhe rendi	7.5	19.4	49.2	20.9	3.0	100
Sistemi i drejtësisë	15.7	31.3	40.3	10.4	2.3	100

Të dhënat e mësipërme tregojnë se një përqindje të konsiderueshem e zënë të anketuarit që mbajnë qëndrime ‘neutrale’ ndaj kënaqësisë apo pakënaqësisë së shërbimeve publike në vend. Vlen të theksohet se vlerësimi “neutral” nënkupton një qëndrim as të kënaqur dhe as të pakënaqur ndaj shërbimeve publike. Treguesi “neutral” nuk është as indiferent, as i parëndësishëm, përkundrazi, është një indikator i pasigurisë kolektive, pritshmërive të ulëta, dhe një qëndrimi pasiv të përkohshëm. Ai pasqyron potencialin për ndryshim në sjelljen sociale dhe në vendimmarrjen për të emigruar, në varësi të zhvillimeve politike, ekonomike dhe institucionale. Për këtë arsye, ky tregues së bashku me të dhënat e mësipërme duhen trajtuar me kujdes të veçantë në analizat mbi migracionin dhe politikën publike.


Në përmbledhje, të dhënat tregojnë se mungesa e mundësive për punësim, pasiguria ekonomike dhe sociale, janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në dëshirën për të emigruar. Kjo analizë ndihmon në identifikimin e fushave prioritare ku ndërhyrjet strukturore dhe përmirësimet konkrete mund të ndihmojnë në zbutjen e presionit migrator nga vendi.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Në një interpretim më gjithëpërfshirës të dhënat tregojnë se mungesa e perspektivës për një jetë të sigurt në vend është një nga arsyet kryesore që nxit dëshirën për emigrim te të rinjtë dhe qytetarët në përgjithësi. Përgjigjet e të anketuarve rreth nivelit të kënaqësisë/ pakënaqësisë ndaj shërbimeve publike dhe funksionimit të institucioneve në vend mbështesin të dhënat e mësipërme të anketës në lidhje me arsyet kryesore të migrimit potencial (figura 13). Ndër arsyet kryesore të migrimit potencial që të anketuarit listojnë lidhen me mundësinë për punësim (37,4%); kushtet ekonomike dhe nivelin e pagave (25,3%); arsimimi dhe sistemi shëndetësor (18,6%); mungesa e perspektivës në vend (4,4%); mungesa e dëshirës për të jetuar në Shqipëri (5,1%), etj.

Gjithashtu vlen të përmendet se krahas pakënaqësisë së migrantve potencial rreth shërbimeve dhe institucioneve në vend, u përpunuan rezultatet në lidhje me këtë tregues edhe për të gjithë banorët e përfshirë në anketim (figura 23).

Figura 23: Shkalla e kënaqësisë /pakënaqësisë ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike në vend (për të gjithë të anketuarit) (%)



Grafiku paraqet perceptimin më të përgjithshëm të qytetarëve, përfshirë edhe ata që nuk planifikojnë të emigrojnë. Në një analizë krahasuese mes qëndrimit të migrantëve potencial dhe qëndrimit të të gjithë të anketuarve bie në sy fakti se:

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

- të dy grafikët ndjekin pothuaj të njëjtën prirje, megjithëse me intensitete të ndryshme të pakënaqësisë. Kjo është një gjetje e rëndësishme, sepse tregon se perceptimet negative ndaj funksionimit të shërbimeve publike janë të përhapura në të gjithë shoqërinë, por shprehen më ashpër tek migrantët potencial.
- ka një % të lartë të banorëve që mbajnë qëndrim ‘neutral’
- migrantët potencial kanë ndjeshëm më shumë pakënaqësi ndaj të gjitha kategorive të shërbimeve publike.
- pakënaqësia më e lartë është e lidhur me sektorët që prekin drejtpërdrejt mirëqenien socio-ekonomike (punësimi, drejtësia, arsimi, shëndetësia).
- tregu i punës, sistemi shëndetësor, sigurimet shoqërore, drejtësia janë një burim i theksuar pakënaqësie edhe për të gjithë të anketuarit
- ndonëse intensiteti i pakënaqësisë është më i madh tek migrantët potencial, struktura e perceptimit është e njëjtë – domethënë qytetarët, pavarësisht vendimmarrjes për emigrim, identifikojnë të njëjtat problematika.

Duke përmbledhur sa më lart, edhe në mesin e të gjithë të anketuarve konstatohet një pakënaqësi e konsiderueshme ndaj shërbimeve publike. Edhe pse një pjesë e të anketuarve nuk kanë plan të emigrojnë përsëri në mesin e tyre shfaqet pakënaqësi ndaj situatës aktuale në vend. Ky mund të jetë një tregues paralajmërues për rritjen e mundshme të migrimit në të ardhmen, nëse këto problematika nuk adresohen. Ngjashmëria e prirjeve midis dy grafikëve sugjeron ekzistencën e një klime strukturore mosbesimi dhe zhgënjimi ndaj institucioneve. Në këtë kontekst mund të thuhet se emigrimi nuk është domosdoshmërisht rezultat i pakënaqësisë unike të një grupi, por më tepër është një përgjigje ndaj një realiteti të përbashkët, ku një pjesë e popullsisë zgjedh të veprojë (migrantët potencialë), ndërsa pjesa tjetër qëndron pasivisht e pakënaqur.

Këta tregues janë tepër domethënës dhe mund të ndihmojnë në riadresimin e politikave publike në funksion të nevojave të qytetarëve, me qëllim krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm social dhe ekonomik, që e bën jetën dhe qëndrimin në vend më të dëshirueshëm sesa emigrimi.

3. NDIKIME DHE PASOJA TË MIGRIMIT TË MUNDSHËM PËR ZHVILLIMIN E RAJONIT


Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës paraqet një ndër sfidat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe demografik të zonës. Ky proces, i cili përfshin si migrimin e brendshëm drejt qyteteve më të mëdha të vendit, ashtu edhe migrimin ndërkombëtar drejt vendeve të Evropës perëndimore dhe më gjerë, pritet të sjellë pasoja të thella dhe të shumëanshme në vitet në vijim. Vlen të theksohet se ky kapitull nuk synon të ofrojë të dhëna statistikore shtesë apo analiza të drejtpërdrejta mbi fenomenin e migrimit potencial, por të funksionojë si një udhëzues konceptual për të kuptuar drejtimit kryesorë në të cilat ky proces mund të ndikojë në zhvillimin e rajonit të Korçës në të ardhmen, bazuar në gjetjet dhe treguesit statistiorë të paraqitur në pjesën e parë dhe të dytë të raportit studimor. Përmes identifikimit të fushave ku migrimi potencial pritet të ketë pasoja sociale, ekonomike, demografike apo kulturore, kapitulli synon të orientojë vëmendjen e studiuesve dhe aktorëve të interesuar drejt dimensioneve që kërkojnë një analizë më të thelluar. Në të njëjtën kohë, ky kapitull merr edhe një funksion praktik, pasi ofron një kuadër të përgjithshëm orientues për politikëbërësit lokalë dhe rajonalë. Duke pasur parasysh se migrimi potencial prek drejtpërdrejt strukturën e tregut të punës, cilësinë e burimeve njerëzore, kohezionin social dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik, njohja e këtyre dimensioneve është e domosdoshme për të ndërtuar politika parandaluese, përshtatëse dhe zhvillimore. Në këtë kuptim, kapitulli nuk jep përgjigje përfundimtare, por propozon pista reflektimi që mund të shërbejnë si bazë për kërkime të specializuara në fusha të ndryshme, duke kontribuar kështu në një kuptim më të plotë të sfidave dhe mundësive që sjell migrimi potencial për të ardhmen e rajonit.

Migrimi potencial në rajonin e Korçës përfaqëson një dukuri në rritje e cila mbart pasoja shumëdimensionale për zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Të dhënat e studimit rreth migrimit të mundshëm të banorëve nga rajoni i Korçës në vitin 2025 tregojnë se mbi 60% e të anketuarve përgatiten ose kanë plan për të emigruar jashtë vendit, dhe rreth 45% mendojnë apo përgatiten për migrim të brendshëm, kryesisht drejt Tiranës. Kjo dinamikë ka pasoja në disa nivele:

Në planin demografik

Nga pikëpamja demografike, largimi i të rinjve dhe personave në moshë pune do të përshpejtojë procesin e plakjes së popullsisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e lindshmërisë dhe në rritjen e varësisë nga grupmoshat joaktive. Ky transformim do të çojë në zvogëlim të fuqisë punëtore dhe në rritjen e nevojës për shërbime të dedikuara për të moshuarit, në një kohë kur burimet lokale janë të kufizuara. Rezultatet e studimit treguan se migrimi potencial prek kryesisht më të rinjtë (49.6% e të anketuarit që janë duke u përgatitur për të migruar) i përkasin grupmoshës 18-24 vjeç) dhe grupmoshën aktive, çka e çon rajonin drejt një strukture demografike më të vjetër. Ky proces përkeqëson raportin ndërmjet popullsisë aktive dhe asaj në moshë pensioni, duke rritur barrën sociale mbi sistemet publike të kujdesit dhe pensioneve. Duke iu referuar treguesve statistikorë sjellim ne vemendje një fakt tepër domethënës që lidhet me koeficientin e varësisë së të moshuarve për rajonin e Korçës. Të dhënat prej INSTAT tregojnë një rritje të këtij raporti përgjatë viteve. Koncretisht në 2001 koeficienti i varësisë së të moshuarve për qarkun Korçë ishte 15.3%; në vitin 2011 ishte 20.5% dhe në vitin 2023 ky koeficient arriti në 37.4%. Raporti i varësisë së të moshuarve në 2023 për qarkun Korçë është më i lartë edhe se mesatarja e këtij raporti për të gjithë Shqipërinë (figura 24).

Figura 24: Raporti i varësisë së të moshuarve sipas, qarkut (%)



Burimi: INSTAT 2024

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Faktorët që ndikojnë në plakjen e popullsisë janë rënia e lindshmërisë dhe migracioni. Studimet tregojnë se qarku me shtesën natyrore më të ulët për vitin 2023 ishte ai i Korçës, me 959 vdekje më shumë sesa lindje në atë vit²⁰. Përpos nivelit të ulët të lindshmërisë për rajonin e Korçës, tendencat në rritje të migrantëve potencial nga ana tjetër ndikojnë fuqishëm në plakjen e popullsisë për këtë rajon. Flukset dalëse migratore prekin kryesisht popullsinë e moshës 20- 40 vjeç, duke ndikuar në plakjen e popullsisë. Të dhënat prej anketimit treguan se 37.5% e migrantëve potencial planifikojnë të emigrojnë brenda vitit dhe 31.6% gjatë 3 viteve të ardhshme; 23.4% e tyre planifikojnë të largohen brenda 5 viteve të ardhshme. Ndërkohë që të rinjtë planifikojnë të largohen brenda një kohe të shkurtër, të moshuarit mbeten duke krijuar një barrë për sistemin ekzistues të pensionit dhe kujdesit shëndetësor. Të anketuarit u pyetën nëse në familjen e tyre jetojnë të moshuar. Përgjigjet e tyre treguan se 36.1% e migrantëve potencial (të anketuarve që përgatiten apo kanë plan të emigrojnë) kanë të moshuar në familjen e tyre, ndërsa 63.9% e tyre nuk kanë të moshuar në familje. Në një analizë më të detajuar të krostabulimit të të dhënave për variablat ‘prania e të moshuarve në familje’ dhe ‘me kë planifikoni të largoheni’ u vu në dukje se 50% e migrantëve potencial që planifikojnë të largohen vetëm kanë të moshuar në familje; 18.1% e atyre që planifikojnë të largohen me partnerin/en kanë të moshuar në familje dhe 31.4 % e migrantëve që planifikojnë të largohen me familjen kanë të moshuar në familje (tabela 14).

Tabela 14: Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘migrim individual/ familjar’ dhe ‘prania e të moshuarve në familje’

		Nëse planifikoni të emigroni, me kë do largoheni?			Total
		Vetëm	Me partnein/en	Me familjen	
Në familjen tuaj jetojnë të moshuar	Po	50.5%	18.1%	31.4%	100.0%
	Jo	39.7%	19.6%	40.7%	100.0%
		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Largimi i të rinjve dhe lënia pas e të moshuarve mund të sjellë pasoja të shumëanëshme si:

²⁰ Shih: INSTAT, Vjetari statistikor rajonal 2023, faqe 50

https://www.instat.gov.al/media/12918/vjetari-statistikor-rajonal-2023_.pdf

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

- përshpejtim i plakjes së popullsisë dhe ngushtimin e bazës kontribuese të sistemit të sigurimeve shoqërore, duke e bërë edhe më urgjente reformimin e politikave sociale dhe zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të kujdesit për të moshuarit.
- izolimi social i të moshuarve të mbetur pas, mungesë e kujdesit të përditshëm dhe varësi më e madhe nga remitancat.
- në planin shoqëror, kjo prire rrit presionin mbi shërbimet sociale dhe shëndetësore, shton kërkesën për kujdes institucional dhe përforcon nevojën për politika mbështetëse që garantojnë kujdes afatgjatë, shërbime komunitare dhe programe për përfshirjen sociale të të moshuarve.

Një tjetër pasojë që mund të sjellë migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës në aspektin demografik lidhet me rrezikun për zbrazjen e zonave rurale dhe periferike. Referuar të dhënave prej anketimit bashki si Pusteci, Maliqi dhe Devolli pritet të përjetojnë shkallë më të lartë të largimit, duke rrezikuar zbrazjen e komuniteteve dhe vështirësimin e ofrimit të shërbimeve bazë si shkollat, qendrat shëndetësore etj. Si pasojë e migrimit të brendshëm dhe largimit të banorëve jashtë vendit pritet gjithashtu të thellohet dukuria e depopullimit të zonave të caktuara, kryesisht rurale. Kjo mund të shoqërohet me pasojat territoriale të dukshme: braktisje e tokave të punueshme, ndërtesat dhe infrastruktura degradojnë, ndërsa popullsia përqendrohet në pak qendra urbane ku shërbimet dhe burimet janë të mbingarkuara.

Në planin ekonomik:

Në aspektin ekonomik emigrimi i vazhdueshëm do të sjellë rënie të konsumit dhe të aktiviteteve prodhuese, sidomos në sektorin bujqësor, që mbetet baza ekonomike e zonës. Sektorët tradicionalë si bujqësia, turizmi dhe shërbimet mund të vuajnë mungesë fuqie punëtore dhe inovacioni. Largimi i të rinjve ndikon në mungesën e ideve të reja dhe përdorimin e teknologjive të reja, duke kufizuar rritjen ekonomike lokale.

Edhe pse remitancat nga emigrantët luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e mirëqenies së familjeve të tyre, ato nuk zëvendësojnë investimet produktive afatgjata dhe shpesh krijojnë varësi ekonomike. Ato shpesh përdoren për konsum bazik, dhe jo për nisma sipërmarrëse apo për krijim të vendeve të reja të punës.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Pasojat në zhvillimin ekonomik të rajonit lidhen edhe me humbjen e kapitalit human si pasojë e dukurisë së migrimit. Tendenca në rritje e migrantëve potencial, kryesisht të rinjve dhe të arsimuarve do të shoqërohet edhe me një migrim të trurit dhe zvogëlim të burimeve humane në vend. Veçanërisht largimi i banorëve të arsimuar ndikon në mungesën e specialistëve dhe dobësimin e bazës zhvillimore lokale. Të dhënat prej studimit treguan se 54.8% e të anketuarve që planifikojnë të largohen kanë arsim të mesëm dhe 35.6% e tyre kanë arsim të lartë. Largimi i personave me arsim të mesëm prek drejtpërdrejt sektorët që mbështeten mbi punën e kualifikuar, por jo domosdoshmërisht të specializuar – si shërbimet, sektori i ndërtimit, bujqësia, etj. Shumica e këtyre sektorëve janë bazë e ekonomisë lokale dhe largimi i kësaj kategorie të fuqisë punëtore rrezikon të sjellë mungesë të punëtorëve aktivë, rritje të kostove të prodhimit dhe ulje të konkurrueshmërisë së rajonit.

Nga ana tjetër, fakti që 35.6% e atyre që planifikojnë të largohen kanë arsim të lartë, paralajmëron një rrezik të qartë për humbjen e kapitalit njerëzor me nivel të lartë kualifikimi. Kjo nënkupton jo vetëm ulje të potencialit inovativ dhe zhvillues në ekonomi, por edhe boshatisje të tregut lokal të punës nga profesionistët. Në plan afatgjatë, kombinimi i këtyre dy prirjeve krijon një presion të dyfishtë mbi zhvillimin ekonomik të rajonit: mungesë të fuqisë punëtore në sektorët bazë dhe humbje të elitës së arsimuar që do të mund të garantonte transformimin strukturor të ekonomisë. Për pasojë, Korça rrezikon të përballet me një cikël negativ ku emigrimi i kapitalit njerëzor ul ritmet e zhvillimit ekonomik, ndërsa mungesa e mundësive të reja zhvillimore nxit valë të reja emigrimi.

Në planin social dhe kulturor

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, përbën një dukuri me ndikime të thella në strukturën sociale dhe kulturore të zonës. Migrimi potencial në Korçë nuk është vetëm një çështje ekonomike apo demografike, por sjell pasoja të thella socio-kulturore. Të dhënat e studimit të vitit 2025 tregojnë se 61.5% e të anketuarve mendojnë të emigrojnë jashtë vendit dhe 44.6% synojnë migrim të brendshëm, kryesisht drejt Tiranës. Ky potencial i lartë migrimi përbën një faktor që pritet të ndryshojë ndjeshëm tiparet socio-kulturore të rajonit në dekadat e ardhshme.

Këto ndryshime lidhen me:

- *Fragmentarizimin e komuniteteve dhe dobësimi i kobezionit social*
Rezultatet e studimit treguan se 64% e migrantëve potencialë janë 18–24 vjeç; 63.8% janë femra dhe 84.8% e tyre kanë ndërmarrë të paktën një hap konkret

për të realizuar projektin e tyre migrator (aplikime për studime/punë/informim aktiv).

Bazuar te këto të dhëna argumentojmë se largimi i të rinjve dhe grupmoshës aktive pritet të sjellë një rënie të ndjeshme të pjesëmarrjes në aktivitetet komunitare, kulturore dhe qytetare. Me rënien e numrit të popullsisë aktive, komunitetet lokale do të përballen me dobësim të solidaritetit tradicional dhe humbje të kapitalit social. Gjithashtu prirja e lartë e grave dhe vajzave për të migruar mund të sjellë boshllëk në strukturat familjare dhe kulturore në vend. Nga ana tjetër migrimi i brendshëm, kryesisht drejt Tiranës thëllon ndarjen “qendër–periferi”, ku fshatrat dhe lagjet periferike të qytetit përballen me shuarje të aktiviteteve publike dhe rënie të kapitalit social.

- *Ndryshim në strukturën familjare*

Migrimi i prindërve të rinj ose i grave sjell impakte në strukturën familjare, ku gjeneratat e moshuara mbeten të vetme ose kujdesen për nipër e mbesa. Bazuar në të dhënat e studimit 52.8 % e migrantëve potencial variojnë nga 25 vjec në 44 vjec. 41.7% e migrantëve potencial të grupmoshës 25- 34 vjeç dhe 45.8% e migrantëve potencial të grupmoshës 35- 44 vjeç jetojnë në familje me katër pjestarë (shih tabela 15). Po ashtu është e konsiderueshme edhe % e migrantëve potenciale të këtyre gruposhave që jetojnë në familje me 5 ose më tepër persona (12.5 % e grupmoshës 25- 34 vjeç) dhe 8.3% e grupmoshës 35- 44 vjeç. Bazuar në këta tregues tepër domethënës theksohet se migrimi i të rinjve nga familja rrezikon të fragmentojë njësitë familjare tradicionale dhe të dobësojë mekanizmat e mbështetjes së brendshme. Gjithashtu % e lartë e migrantëve potencial që jetojnë në familje të mëdha (me pesë ose me shumë anëtarë) tregon se pas largimit të tyre, një numër i konsiderueshëm i të moshuarve do të mbeten pa mbështetjen direkte të brezit të ri. Kjo gjendje sjell pasoja si rritja e vetmisë dhe izolimit social të të moshuarve, reduktimi i kujdesit familjar tradicional, rritja e kërkesës për shërbime sociale dhe kujdes institucional, si dhe dobësimi i rolit të tyre aktiv në komunitet. Në planin afatgjatë, kjo mund të përshpejtojë procesin e plakjes së popullsisë në rajon, të dobësojë kohezionin social dhe të krijojë një pabarazi të re sociale ndërmjet atyre që kanë mbështetje familjare dhe atyre që mbeten të vetmuar.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Tabela 15: Krostabulimi i të dhënave për variablat ‘grupmosha’ dhe ‘numri i anëtarëve në familje’ (të dhënat janë filtruar vetëm për të anketuarit që kanë plan apo përgatiten për të migruar)

	Numri i antëtarëve në familjen tuaj				Total
	Dy	Tre	Katër	Pesë ose më shumë	
Grupmosha					
18-24 vjeç	1.5%	4.5%	42.4%	51.5%	100.0%
25-34 vjeç	20.8%	25.0%	41.7%	12.5%	100.0%
35-44 vjeç	12.5%	33.3%	45.8%	8.3%	100.0%
45-54 vjeç	26.7%	26.7%	33.3%	13.3%	100.0%
Mbi 55 vjeç	75.0%		25.0%		100.0%
Total	12.0%	15.8%	41.4%	30.8%	100.0%

Studimi tregoi se 9.1% e migrantëve potencialë synojnë të largohen për arsye të ribashkimit me pjesën tjetër të familjes, një tregues se fragmentimi i familjes tashmë është realitet në shumë raste. Kjo gjendje sjell rritje të kërkesës për shërbime sociale dhe mbështetje për të moshuarit, të cilët humbin funksionin e tyre tradicional si mbështetje e brezit të ri.

- *Trashëgimia kulturore, praktikat dhe identiteti lokal*

Migrimi i të rinjve ul gjasat për trasmetimin ndërbrezor të zakoneve, traditave dhe riteve kulturore. Në bashkitë rurale si Devoll, Maliq dhe Pustec, ku shifrat e migrimit potencial janë të larta, rrezikohet shuarja e aktiviteteve kulturore tradicionale për mungesë pjesëmarrësish. Gjithashtu të dhënat prej anketimit treguan se 26.7% e të anketuarve në Pogradec janë në faza përgatitore për migrim, çka tregon se edhe zonat turistike me tradita kulturore të pasura përballen me risk të lartë për humbje të identitetit kulturor lokal.

- *Varësinë nga diaspora dhe transformimi i roleve sociale*

Studimi tregoi se 20.5% e atyre që përgatiten për të emigruar raportuan se ndihmohen nga familjarët ose të afërmit jashtë vendit, duke treguar rolin qendror që luajnë rrejtet sociale dhe diaspora për të përmbushur planin migrator të migrantëve të mundshëm. Diaspora kthehet jo vetëm në burim ekonomik (përmes remitancave), por edhe në faktor ndikues mbi vendimmarrjen familjare dhe normat sociale. Kjo e zhvendos qendrën e ndikimit nga komuniteti lokal drejt atyre që jetojnë jashtë vendit. Për shkak të kësaj varësie, modeli i suksesit identifikohet gjithnjë e më shumë me largimin nga vendi, duke ndikuar në kulturën e aspiratave të brezit të ri.

Ndikime në institucionet vendore

Reduktimi i popullsisë ndikon drejtpërdrejt në të ardhurat e bashkive dhe kapacitetin e tyre për të investuar në infrastrukturë dhe shërbime. Kjo përkeqëson më tej cilësinë e jetës për banorët e mbetur dhe nxit një cikël të mbyllur largimi. Nga ana tjetër migrimi e bën të paparashikueshmë planifikimin urban, arsimin, shëndetësinë dhe nevojat për infrastrukturë publike. Institucionet përballen me sfida për të projektuar politika të qëndrueshme në një realitet që ndryshon vazhdimisht për shkak të lëvizjeve demografike.

PËRFUNDIME

Studimi mbi migrimin potencial të banorëve nga rajoni i Korçës tregoi se kjo dukuri përfaqëson një prirje të fuqishme, e cila pritet të ketë pasoja të thella demografike, ekonomike dhe socio-kulturore për rajonin në të ardhmen. Të dhënat tregojnë se 61.5% e të anketuarve shprehin synim për emigrim jashtë vendit, ndërsa 44.6% planifikojnë migrim të brendshëm, kryesisht drejt Tiranës (76%). Ky nivel i lartë i gatishmërisë për migrim, i shoqëruar me faktin se 84.8% e të anketuarve kanë ndërmarrë tashmë hapa konkretë, tregon se migrimi nuk është thjesht një aspiratë e largët, por një proces në zhvillim e sipër. Migrimi i brendshëm, kryesisht drejt Tiranës nuk është vetëm pasojë e mungesës së mundësive në zonat e tjera, por sidomos e përqendrimit të avantazheve konkurruese në kryeqytet. Kjo prirje krijon sfida të mëdha për zhvillimin e balancuar rajonal, pasi ndihmon në zbrazjen demografike të zonave urbane dhe rurale të rajonit të Korçës nga njëra anë dhe dhe mbingarkesën urbane të kryeqytetit, nga ana tjetër.

Në planin demografik, studimi tregoi se migrimi potencial është i përqendruar kryesisht te të rinjtë (64% e të rinjve shfaqin gatishmëri për t'u larguar), çka e zhvendos barrën e popullsisë së rajonit drejt moshave më të mëdha. Po ashtu, fakti që 63.8% e migrantëve potencialë janë femra tregon një ndryshim të rëndësishëm në rolet tradicionale gjinore dhe përbën sfidë për strukturën sociale dhe ekonomike të komunitetit. Këto tregues paralajmërojnë një plakje të përsheptuar të popullsisë, duke lënë pas një numër të lartë të moshuarish pa mbështetje të drejtpërdrejtë familjare. Në planin arsimor e profesional, rezulton se 54.8% e migrantëve potencialë kanë arsim të mesëm dhe 35.6% arsim të lartë, çka nënkupton humbje të kapitalit njerëzor dhe të burimeve më të rëndësishme për zhvillimin lokal. Migrimi i individëve të arsimuar shkurton mundësitë për inovacion dhe përmirësim të shërbimeve publike në rajon.

Nga pikëpamja e arsyeve dhe motiveve që çojnë drejt synimit për të migruar, analiza e të dhënave të studimit tregoi se vendimmarrja për migrim e banorëve nga rajoni i Korçës nuk është produkt i një faktori të vetëm, por rezultat i një ndërthurjeje komplekse të faktorëve “shtytës” dhe “tërheqës”, të cilat lidhen ngushtësisht me realitetin socio-ekonomik dhe kulturor të rajonit. Motivet ekonomike përbëjnë faktorin kryesor: mungesa e mundësive për punësim të qëndrueshëm, nivelet e ulëta të të ardhurave dhe perceptimi i kufizuar për përmirësim të cilësisë së jetesës në vend shtynë individët, veçanërisht të rinjtë, drejt kërkimit të alternativave jashtë rajonit.

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

Ky faktor është i lidhur edhe me dëshirën për avancim arsimor dhe profesional, pasi një pjesë e konsiderueshme e migrantëve potencialë e shohin emigrimin si mjet për të fituar njohuri, aftësi dhe mundësi që nuk ofrohen në tregun vendas. Një tjetër faktor me ndikim në prirjen për migrim të mundëshëm është ribashkimi familjar, i cili dëshmon për fragmentimin e hershëm të strukturës familjare dhe për transformimet që migrimi tashmë ka shkaktuar në jetën e komuniteteve lokale. Shumë individë e shohin emigrimin jo vetëm si një zgjedhje personale, por si pjesë e një strategjie kolektive të familjes për të siguruar mirëqenie dhe unitet social.

Rrjetet sociale të migrantëve jashtë vendit përbëjnë një faktor domethënës që motivon dhe mbështet prirjen për migrim të banorëve. Të dhënat prej studimit treguan se 20.5% e atyre që përgatiten për emigrim mbështeten nga familjarë, të afërm apo miq, që jetojnë jashtë vendit, duke treguar varësinë në rritje nga rrjetet migratore ekzistuese. Ndikimi i rrjeteve sociale të migrantëve lidhet jo vetëm me vendimmarrjen për të migruar, por dikton gjithashtu edhe destinacionin e migrimit. Rrjetet e migrantëve shërbejnë si një instrument lehtësues të procesit migrator, duke u siguruar migrantëve potencial të gjithë informacionin e nevojshëm për mënyrën e jetesës dhe kushtet e qëndrimit në vendin pritës, si edhe duke ulur kostot dhe rreziqet e largimit. Të dhënat e studimit treguan se prirjet kryesore të migrimit potencial nga rajoni i Korçës orientohen kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke reflektuar tërheqjen e fortë që këto hapësira kanë për popullsinë lokale. Kjo lidhet jo vetëm me perceptimin e standardeve më të larta të jetesës dhe mundësive për punësim e arsimim cilësor, por edhe me praninë e gjatë dhe të konsoliduar të diasporës shqiptare në këto vende, e cila funksionon si rrjet mbështetës dhe faktor nxitës i vazhdueshëm për migrim. Për më tepër, destinacionet e tilla pasqyrojnë logjikën e migrimit të orientuar drejt sigurisë ekonomike, stabilitetit institucional dhe perspektivave afatgjata për integrim social e profesional.

Në përfundim, arsyet dhe motivet e migrimit në rajonin e Korçës janë të shumëfishta dhe të ndërthurura: ekonomike, arsimore, familjare, etj. Kjo ndërlikueshmëri shpjegon shkallën e lartë të migrimit potencial dhe e pozicionon migrimin si një strategji të përgjithshme të familjeve dhe individëve për t'u përshtatur ndaj realiteteve të reja socio-ekonomike. Në këtë kontekst, migrimi potencial nuk është vetëm një zgjedhje personale, por pasqyrë e sfidave strukturore dhe mungesës së perspektivës në vend. Kuptimi i balancës mes këtyre faktorëve është thelbësor për të ndërtuar politika efektive që parandalojnë zbrazjen e vazhdueshme të vendit nga burimet e tij më të çmuara; kapitali human.

Të dhënat e studimit evidentuan dallime të rëndësishme midis migrimit individual dhe atij familjar. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve, sidomos ata të grupmoshës 18–24 vjeç, planifikojnë të migrojnë individualisht, kryesisht për arsye arsimore dhe profesionale, duke synuar krijimin e një karriere personale jashtë vendit. Në të kundërt, të anketuarit në moshë më të pjekur shfaqin një tendencë më të theksuar drejt migrimit familjar. Kjo prirje krijon pasoja të ndryshme. Nga njëra anë migrimi individual çon në zbrazjen e komuniteteve nga të rinjtë dhe humbjen e potencialit njerëzor për zhvillim. Nga ana tjetër, migrimi familjar ka një ndikim të madh në planin demografik në uljen e lindshmërisë, në depopullimin e zonave të caktuara, kryesisht të largëta rurale, si dhe në ndryshimin e strukturës familjare në vend. Shumë bashki rurale raportojnë humbje të ndjeshme të popullsisë shkollore për shkak të largimit të të gjithë familjeve drejt emigracionit. Në tërësi, migrimi familjar shqiptar pasqyron një tranzicion nga emigrimi i pasigurt dhe individual drejt planeve të qëndrueshme jetese jashtë vendit, i lidhur me synime afatgjata për integrim dhe siguri sociale.

Gjtuashtu studimi tregoi një marrëdhënie komplekse midis kushteve ekonomike dhe vendimmarrjes për migrim. Konkretisht gjetjet prej anketimit treguan se grupet me të ardhura mesatare janë më të prirura për të emigruar. Migrimi potencial mbetet i lartë edhe në mesin e familjeve me të ardhura nën mesatare. Këto të dhënat tregojnë se migracioni shqiptar realizohet nga individë dhe familje që kanë mjaftueshëm burime për të mbuluar koston fillestare të migrimit dhe presin përfitime më të mëdha ekonomike në vendin e destinacionit. Pra, në konkstin aktual migrimi nuk përbën më thjesht një strategji mbijetese, por konsiderohet si një projekt i gjerë i përmirësimit të standardeve të jetesës, i cili kombinon elementë të nevojës ekonomike me aspiratat për siguri dhe stabilitet socio-ekonomik. Studimi tregoi se familjet me të ardhura mesatare shfaqin prirje të lartë për migrim, çka sugjeron se migrimi nuk është thjesht një strategji mbijetese për shtresat më të varfra, por një projekt i orientuar drejt sigurimit të stabilitetit socio-ekonomik. Pavarësisht të ardhurave, pakënaqësia e lartë me cilësinë e shërbimeve publike, veçanërisht në arsim, shëndetësi dhe punësim krijon një perceptim të pasigurt për të ardhmen. Në këtë kontekst, migrimi shihet si rruga më e besueshme për të garantuar standard më të lartë jetese, siguri afatgjatë dhe mundësi më të gjera për gjeneratat e reja. Ky kombinim i synimeve për përmirësim me pakënaqësinë ndaj kushteve ekzistuese e kthen migrimin në një zgjedhje racionale, përtej domosdoshmërisë së mbijetësës.

Studimi tregoi qartë një lidhje domethënëse midis kohës së planifikuar për migrim dhe nivelit të konkretizimit të planit migrator. Ata që duan të migrojnë shpejt janë më të përgatitur, më të angazhuar dhe kanë më shumë lidhje me rrejetet

sociale dhe institucionale. Ndërsa ata që e shtynë planin në kohë, shfaqin pasiguri, mungesë burimesh apo nevojë për më shumë informim. Kohëzgjatja e qëndrimit të planifikuar në vendin pritës është një tjetër treguesi rëndësishëm për të kuptuar mënyrën si duhet orientuar politika migratore, zhvillimi rajonal dhe planifikimi social. Studimi tregoi një përputhje midis kohëzgjatjes së planit migrator dhe mungesës së planit për kthim. Individët që planifikojnë migrim afatshkurtër shfaqin prirje më të lartë për t'u rikthyer në atdhe, shpesh duke e parë migrimin si një fazë të përkohshme që shërben për akumulimin e kapitalit financiar dhe profesional. Në të kundërt, ata që synojnë migrim afatgjatë ose të përhershëm shpesh lidhin të ardhmen e tyre me integrimin në vendet pritëse dhe manifestojnë një gatishmëri më të ulët për rikthim, sidomos kur në procesin migrator përfshihet e gjithë familja.

Të dhënat treguan se një pjesë e madhe e migrantëve potencial nuk e konsiderojnë emigrimin si një hap të përkohshëm, por si një ndryshim të përhershëm ose afatgjatë, shpesh pa synim kthimi. Këto të dhëna tregojnë se planifikimi i migrimit dhe motivet që e shoqërojnë (arsim, punë, përmirësim i standartit të jetesës, ribashkim familjar, etj) janë përcaktues kyç të raportit me vendlindjen, duke ndikuar drejtpërdrejt në perspektivën e zhvillimit demografik dhe social të rajonit të Korçës. Kjo sjell pasoja të rëndësishme për vendin e origjinës, si humbja e kapitalit njerëzor, dobësimi i forcës punëtore, tkurrja e popullsisë aktive dhe sfida për zhvillimin ekonomik e social afatgjatë. Për më tepër, pasiguria që shfaqin të anketuarit mbi kthimin apo kohëzgjatjen e qëndrimit jashtë vendit tregon se shumë vendime migrimi po merren në mënyrë jo të strukturuar, ndoshta të shtyra nga faktorë të fortë shtytës si pasiguria ekonomike dhe sociale në vend. Në lidhje me këtë aspekt studimit tregoi se se një pjesë e migrantëve potencial e konsiderojnë kthimin në vendlindje si një alternativë të mundshme, por të kushtëzuar ngushtësisht nga përmirësimi i kushteve ekonomike dhe cilësisë së jetesës në vend. Niveli i ulët i kënaqësisë ndaj institucioneve dhe shërbimeve publike del si një nga arsyet themelore të prirjes për largim: mbi gjysma e migrantëve potencial dhe një përqindje e lartë e të gjithë të anketuarve janë shprehur të pakënaqur ose neutralë me cilësinë e punësimit, shëndetësisë dhe arsimit, duke treguar për një mangësi të dukshëm në ofrimin e shërbimeve bazë. Kjo pakënaqësi lidhet drejtpërdrejt me perceptimin e mungesës së perspektivës në vend, ndërsa rikthimi konsiderohet i mundur vetëm nëse këto kushte përmirësohen ndjeshëm.

Këto tregues janë shumë të vlefshëm për hartimin e politikave parandaluese dhe ripërthithëse, sepse ndihmojnë në identifikimin e profileve të atyre që kanë më shumë gjasa të largohen përgjithmonë dhe të atyre që mund të kthehen nëse

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

kushtet përmirësohen. Në këtë mënyrë, studimi nuk ofron vetëm një pasqyrë të situatës, por edhe një bazë për të orientuar ndërhyrje të qëndrueshme. Në këtë kuadër, është e nevojshme që politikat publike dhe nismat zhvillimore të adresojnë faktorët shtytës të migrimit, përmes krijimit të mundësive reale për punësim, arsim cilësor dhe përfshirje sociale. Vetëm në këtë mënyrë mund të frenohet humbja e kapitalit njerëzor dhe të garantohet një e ardhme më e qëndrueshme për rajonin e Korçës.

Në aspektin socio- kulturor, migrimi potencial kërcënon trasmetimin ndërbrezor të zakoneve dhe traditave lokale, sidomos në zonat ku prirja për migrim është më e lartë. Humbja e të rinjve si bartës të kulturës vendore dhe si aktorë të turizmit kulturor rrezikon autenticitetin dhe gjallërinë e jetës komunitare.

Duke marrë në konsideratë të gjitha të dhënat prej anketimit në lidhje me prirjen e banorëve nga rajoni i Korçës për të migruar brenda dhe jashtë vendit, përmasat e migrimit potencial, së bashku me identifikimin e karakteristikave demografike e socio- ekonomike të migrantëve potencial si edhe prirjen për kthim, ose jo në vendlindje konkludohet se migrimi potencial në rajonin e Korçës:

- Së pari, është i përhapur gjerësisht dhe ka gjasa të realizohet në shkallë të lartë, duke ndikuar drejtpërdrejt në strukturën demografike.
- Së dyti, prek kryesisht të rinjtë dhe gratë, duke krijuar hendek në fuqinë punëtore dhe në kohezionin social.
- Së treti, dobëson kapitalin njerëzor të arsimuar dhe prish ekuilibrin e zhvillimit lokal.
- Së katërti, nxit fragmentim të familjeve dhe lë pas të moshuar të pambështetur.
- Së pesti, rrezikon trashëgiminë kulturore dhe traditat vendore.
- Së gjashti, forcon varësinë nga diaspora dhe e zhvendos modelin e suksesit jashtë kufijve të rajonit.
- Së fundi, banorët e rajonit të Korçës karakterizohen nga një profil migrator i qëndrueshëm. Ky profil pasqyron jo vetëm reagimin ndaj kushteve ekonomike e sociale, por edhe një kulturë të konsoliduar migrimi, ku lëvizja jashtë vendit shihet si alternativë kryesore për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e perspektivës.

Këto përfundime nënvizojnë domosdoshmërinë e hartimit të politikave të integruara që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës, krijimin e mundësive ekonomike e sociale për të rinjtë dhe forcimin e lidhjes me diasporën në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit të Korçës.

REFERENCA:

- Barjaba K. (2000) Contemporary patterns in Albanian migration, *South-East Europe Review*, 3(2): 57–64.
- Becker, G. (1962). Investment in Human Capital: A Theoretical Analysis. *Journal of Political Economy*, 70(5 Part 2), 9–49.
- Benson, M. and O'Reilly, K., (2009), Migration and the search for a better way of life: A critical exploration of lifestyle migration, *Sociological Review*, 57(4): 608–625
- Bourdieu P., (1986), The forms of capital, in Handbook of Theory and Research for the Sociology of Education, ed. John C. Richardson, 241–258, Greenwood Press, New York
- Buletini Statistikor, Bashkia Korçë, 2008, Botimi i USAID & CSDC
- Carletto C, Davis B, Stampini M, Trento S & Zezza A., (2004), Internal mobility and international migration in Albania, ESA Working Paper No.04-13
- Carletto G., Davis B., Stampini M., Zezza A. (2006) A country on the move: international migration in post-communist Albania, *International Migration Review*, 40(4): 767–85.
- Castles, S., & Miller, M. J. (2003). The Age of Migration. London: MacMillan Press Ltd.
- Coleman J. S., (1990), Foundation of Social Theory, Harvard University Press
- Esipova N., Ray J., Srinivasan R. (2011). World's Potential Migrants (Who they are, Where they want to go and Why it matters), Gallup
- Esipova N., Ray J., Pugliese A. (2017). Number of potential migrants worldwide tops 700 million, Gallup News, 8 June
- European Training Foundation (2007) The Contribution of Human Resources Development to Migration Policy in Albania. Turin: ETF.
- Fussell, E & Massey S. D., (2004), The limits to cumulative causation: International migration from Mexican urban areas, *Demography*, Vol. 41, No. 1, pp. 151–171, JSTOR
- Gallup World Poll 2013–2016 www.gallup.com/poll/211883/number-potential-migrantsworldwide-tops-700-million.aspx
- Gëdesh, I., & King, R. (2018). Tendencat e reja të migrimit potencial nga Shqipëria, QSES
- Gëdeshi I & Jorgoni E., (2012), Social impact of emigration and rural-urban migration in Central and Eastern Europe- Final country Albania, INSTAT 2004, Migracioni në Shqipëri- Censi i polullsisë dhe banesave 2001, https://www.instat.gov.al/media/3117/migracioni_n_shqiperi.pdf

- INSTAT 2013, Censuri i popullsisë dhe banesave 2011 - Qarku Korçë,
https://www.instat.gov.al/media/3065/7_korce.pdf
- INSTAT 2023, Vjetari statistikor rajonal 2023
<https://www.instat.gov.al/media/12918/vjetari-statistikor-rajonal-2023.pdf>
- INSTAT 2024, Censi i popullsisë dhe banesave 2023, -Qarku Korçë,
<https://www.instat.gov.al/media/14333/cens-2023-korca.pdf>
- INSTAT 2024, Statistikat e pagave, tremujori i IV 2024,
<https://www.instat.gov.al/media/14984/statistikat-e-pagave-tremujori-iv-2024.pdf>
- INSTAT 2022. Tregu i punës 2021,
<https://www.instat.gov.al/media/10066/tregu-i-punes-2021.pdf>
- IOM.(2018). Migration Profile of Albania.www.instat.gov.al
- IOM.(2008). Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer.
- IOM.(2007), Fjalorth i terminologjisë Profile, migratore
<http://publications.iom.int/system/files/pdf/iml10.pdf>
- IOM.(2007), The Republic of Albania- Migration
https://publications.iom.int/system/files/pdf/mp_albania2007.pdf
- IOM. (2020). Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri
- IOM.(2021).Migration Governance Indicators Profile: Albania.
<https://www.iom.int>
- Israel D. G., (1992). Determing sample size, Univesity of Florida, PEOD6
- King R. (2005) Albania as a laboratory for the study of migration and development, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 7 (2): 133–155
- Lazcko F., Tjaden J., Auer D. (2017) Measuring Global Migration Potential, 2010–2015. Berlin: Global Migration Data Analysis Centre, Data Briefing Series
- Lee E. S. (1966), A Theory of Migration, *Demography*, Vol. 3, No. 1. pp. 47-57, JSTOR,
- Lovo, S. (2014). Potential migration and subjective well-being in Europe. IZA J Migration 3, 24, <https://doi.org/10.1186/s40176-014-0024-5>
- Maroukis Th & Gemi E.,(2011), Circular migration between Albania and Greece:a case study, Metoikos Project, European University Institute
- Massey D. S., Arango J., Hugo G., Kouaouci A., Pellegrino A and Taylor J. E., (1993), Theories of international migration- A review and appraisal. *Population and Development Review*. Vol. 19, No. 3, 431-466
- Schultz, T. W. (1961). Investment in Human Capital. *The American Economic Review*, 51(1), 1-17

- Titili, D., (2023). Migrimi dhe kultura (Ndikime sociale dhe kulturore të dukurive migratore në rajonin e Korçës” PromoPrint Publishing House, Korçë, ISBN 978-9928-146-87-8
- Titili, D. & Nikaj, I. (2024). *Gender Dimensions of Albanian Migration*. Migration Letters, Vol. 21 (4), 2024, pp. 1656- 1663,
<https://migrationletters.com/index.php/ml/article/view/8301>
- Vullnetari, J.(2007). Albanian Migration and Development: State of the Art Review,IMISCOE Working Paper No.18,
- Vullnetari, J.(2012). Albania on the Move- Links between Internal and International Migration, Amsterdam University Press
- UNDP & UN Women Albania (2020). *Gender and Migration in Albania*.
- Westminster Foundation for Democracy (2020). *Demographic change in Albania: Implications for democracy and development*. London: WFD. Nxjerrë nga <https://www.wfd.org/>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Titili, Denisa

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës / Denisa Titili, Maria Dojçe, Viola Dolani, Eljona Tasho, Irena Nikaj. -

Korçë : Promo Print, 2025.

88 f. ; 17 x 24cm.

ISBN 9789928836090

I.Dojçe, Maria II.Dolani, Viola III.Tasho, Eljona IV.Nikaj, Irena

1.Sociologjia 2.Migrimi i brendshëm 3.Emigrimi dhe imigrimi 4.Aspekte sociale 5.Korçë

316.4 .063 :314.15(496.564)

Migrimi potencial i banorëve nga rajoni i Korçës

